



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

# **RAPORT MBI ANALIZËN VJETORE 2016**

Shkurt 2017,

|  |    |
|--|----|
| <i>HYRJE</i> .....   | 3  |
| I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR<br>KRIMINALITETIT.....                               | 4  |
| II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE<br>PUNËS SË PROKURORISË.....                         | 5  |
| II/1. Volumi i Punës.....  | 5  |
| II/2. Burimet e referimit të çështjeve penale të rregjistruara gjatë vitit 2016.....               | 8  |
| II/3. Treguesit e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale të trajtuara gjatë<br>vitit 2016..... | 10 |
| II/4. Mosfillimet e procedimeve penale gjatë vitit 2016.....                                       | 13 |
| II/5. Çështjet penale të pushuara gjatë vitit 2016.....  | 14 |
| II/6. Çështje penale të dërguara për gjykim gjatë vitit 2016.....                                  | 15 |
| II/7. Çështjet penale të pezulluara gjatë vitit 2016.....  | 17 |
| II/8. Çështjet penale të transferuara gjatë vitit 2016.....  | 19 |
| II/9. Treguesit e të pandehurëve.....  | 19 |
| II/10. Treguesit e masave të sigurimit.....  | 20 |
| III. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TE PUNËS.....  | 21 |
| III/1. Treguesit e efektivitetit në gjykim dhe dënime.....   | 21 |
| III/2. Treguesit e ngarkesës për Seksionin e të Miturve gjatë vitit 2016.....                      | 24 |
| III/3. Shpejtësia në hetime dhe zgjatja e afatit të hetimeve paraprake gjatë<br>vitit 2016.....    | 25 |
| III/4. Shfuqizimet e akteve të prokurorëve gjatë vitit 2016.....                                   | 26 |
| III/5. Përgjimet.....  | 26 |
| III/6. Apelimet e bëra nga Prokuroria gjatë vitit 2016.....  | 27 |
| IV. NGARKESA E PUNËS SË PROKURORËVE DHE OFICERËVE TË<br>POLICISË GJYQËSORE GJATË VITIT 2016.....   | 28 |
| V. TREGUESIT E NGARKESËS PËR NJËSINË E PËRBASHKËT<br>HETIMORE GJATË VITIT 2016.....                | 30 |
| V/1. Sekuestrime.....  | 34 |
| V/2. Konfiskimet.....  | 35 |
| VI. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME JASHTË GJATË VITIT<br>2016.....                                 | 36 |
| VII. EKZEKUTIMET E VENDIMEVE PENALE GJATË VITIT 2016.....  | 37 |
| VIII. ADMINISTRIMI I PROKURORISE PËR VITIN 2016.....   | 37 |

|         |  |    |
|---------|--|----|
| VIII/1. | Marrëdhëniet me zyrën e financës.....                              | 37 |
| VIII/2. | Marrëdhëniet me institucionet e tjera.....                         | 37 |
| VIII/3. | Etika.....   | 38 |
| IX.     | DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR<br>KRIMINALITETIT ..... | 39 |
| X.      | TABELA ME TREGUES.....   | 40 |

## HYRJE

Ky raport pasqyron në mënyrë të përmblëdhur rezultatet e veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, gjatë vitit 2016. Ai është përqëndruar në analizën e treguesve kryesore sasiorë të punës, treguesit cilësorë referuar edhe qëndrimeve të gjykatës, treguesit për secilin prokuror, problematikën gjatë ushtrimit të funksioneve të prokurorit në hetimet paraprake dhe në gjykim, me synimin për të evidentuar mangësitë dhe arritjet me qëllim përmirësimin e treguesve të punës për vitin që vijon.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, sipas organikës së miratuar nga Prokuroria e Përgjithshme, dhe dërguar me shkresën nr.306/19 prot datë 27.01.2016, të miratuar me urdhërin nr.40 datë 21.01.2016, për ushtrimin e veprimtarisë së saj, ka patur për vitin 2016 një organikë prej 45 punonjësish nga të cilët: 20 prokurorë, (ku përfshihen 1drejtues dhe 2 zv/drejtues, 10 oficerë të policisë gjyqësore, 1 kancelar, 1 k/sekretare, 1finaciere, 1 shofer, 1 ftues, 1 punonjës I.T., 7 sekretare/operatore dhe 1 punonjës pastrimi).

Sipas organizimit të brendshëm, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë kanë funksionuar rregullisht dy seksione, Njësia e Përbashkët Hetimore Kundër Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit, aktualisht me 4 prokurorë (1 zv/drejtues dhe 3 prokurorë) ku më pas është shtuar edhe një prokuror dhe Seksioni i të Miturve dhe Ekzekutimit të Vendimeve Penale, me 2 prokurorë.

## I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT.

Prokuroria e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Kushtetutën, me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, si dhe gjithë kuadrin ligjor që rregullon mënyrën e organizmit të këij institucioni, mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale nga prokurori, ngritjen akuzës, kryerjen e hetimeve, në respektim të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut si dhe në bashkëpunim me faktorë të tjerë shoqëror, ndërinstitutional.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut është konsideruar si një prioritet i punës së prokurorisë për vitin 2016 dhe veçanërisht , në lidhje me respektimin e të drejtave të të miturit në procesin penal: Në çdo rast i është siguruar të miturit në procesin penal mbrojtja e tij me avokat dhe padyshim prania e një psikologu për mbrojtjen e të drejtave të tij. Është treguar kujdes në njoftimin e menjëhershëm të personave kujdestar të të miturit, qoftë prindi apo tjetër; në fshehtësinë e informacionit dhe ndalimin e publikimit për të miturit e abuzuar, apo palë në proces, veçanërisht për çështje që kanë ndjeshmëri në opinionin publik. Në rastet e të miturve në cilësinë e të pandehurve janë aplikuar masa sigurimi të përshtatshme duke treguar kujdes, në mënyrë mosndëprerjen e procesit edukativ dhe riintegrimin e tij në shoqëri si dhe në lidhje me masat e dënimit, janë shtuar rastet e dënimeve alternative apo janë vlerësuar me kudes çdo material që në fazën e referimit të tij.

Në respektim të mbrotjes së të drejtave të miturve, të përfshirë në procedime penale, është respektuar edhe udhëzimi nr.03 datë 25.11.2013 i Prokurorit të Përgjithshëm, “ Për hetimin e veprave penale, ku i mituri përfshihet si i pandehur, person në hetim, dëshmitar apo i dëmtuar”, në të cilin përcaktohet qartë detyrimi që ka çdo prokuror, oficer policie etj në trajtimin me përgjegjshmëri të rasteve ku i mituri është prezent, në mënyrë që të mos cënohen liritë dhe të drejtat e tij të njohura me ligj, Kushtetutë dhe akte ndërkombëtare.

Krijimi i seksionit të miturve është një nga garancitë për respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe trajtimin e të miturve në procesin penal, duke mbetur si një nga seksionet me rëndësi pranë kësaj prokurorie, në mbështetje të ndryshimeve të reja ligjore e kushtetuese, (ligj nr.97/2016) , përkrah krijimit me Dekret të Presidentit nr.5351 datë 11.06.2007.

Gjatë vitit 2016 i është kushtuar prioritet luftës kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, duke vlerësuar çdo material të referuar si nga insitucionet bashkëpunuese, Tatim Taksat, KLSH, FIU, Drejtoria e Policisë apo çdo qytetar, duke rritur hetimin për veprat penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Në këtë drejtim vlerësohet puna e Njësisë së Përbashkët Hetimore Task Forcë, *(e cila me ndryshimet në ligjin e ri të Prokurorisë, nr.97/2016, ka përfunduar ekzistencën e saj si strukturë brënda prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë)* ku përmes hetimeve të prokurorëve dhe oficerëve të kësaj njësie është bërë e mundur sekuestro e pasurive në vlera të mëdha. Lufta ndaj korrupsionit dhe krimit ekonomik do të vazhdojë të jetë një nga prioritetet e kësaj prokurorie, duke koordinuar punën me struktura të tjera ligjzbatuese.

Ndjeshmëri të lartë për vitin 2016 ka paraqitur edhe krimi në fushën e narkotikëve, dhe trafikëve të paligjshme, ku rezulton se ka pasur referime të shumta për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, “ Prodhim dhe mbajtja e narkotikëve” , qoftë dhe në sasi të vogla. Gjatë këtij viti ka pasur gjithashtu referime të materialeve që lidhen me kapjen e mjeteve motorrike, konkretisht gomoneve, të pamtrikulluara me dyshime për trafik të lëndëve narkotike, ku në disa raste janë dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Gjithashtu, në raport me vitet e mëparshme ka pasur një rritje të identifikimit të mjeteve me narkotikë, por jo identifikim dhe kapje të autorëve të tyre. Duke u konsideruar si një nga prioritet kryesore lufta kundër narkotikëve, janë organizuar në nivele vendore takime me përfaqësues të njëjësive territoriale, ku kultivimi paraqitet problematik, përfaqësues të Prefekturës, Prokurorisë dhe Drejtorisë së Policisë Vlorë.

Vlen të theksohet se në hetimin e këtyre grup veprave penale, janë përdorur metodat proaktive të hetimit, ku përgjimet dhe autorizimet e vëzhgimeve janë konsideruar si mjete më efikas në zbulimin dhe identifikimin e autorëve të veprës penale.

Në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, letërporosi, njohje vendimi të huaj, ekzekutim i letërporosive, ekstradime etj, ka pasur zhvillime të mëtejshme. Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar ka ndikuar ndjeshëm në çështjet që lidhen me trafiket e paligjshme, dhe konkretisht me autoritetet gjyqësore Italiane. Vlen të përmendet edhe shtimi i kërkesave për bashkëpunim veçanërisht në fushën e krimit kibernetik, si një nga hetimet komplekse dhe i cili kërkon njohuri të posaçme. Bashkëpunimi gjithashtu në hetimin e këtyre veprave penale me Drejtorinë e Policisë Tiranë, seksioni përkatës, ka qënë pozitiv në një nivel të kënaqshëm në shkëmbim idesh dhe njohurish. Po kështu edhe bashkëpunimi më gjykatën për lejimin e sekuestrove është një ndihmë në hetimin e këtyre çështjeve penale.

## **II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË**

### **II/1. Volumi i Punës**

Gjatë vitit 2016, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë rregjistruar gjithsej 3825 kallëzime dhe referime për vepra të ndryshme penale. Prej tyre janë rregjistruar gjithsej 2532 proçedime penale dhe është vendosur mosfillimi për 1313 kallëzime penale. Janë mbartur nga viti 2015 gjithsej 726 proçedime penale si dhe 140 materiale në verifikim, për vitin 2016, të cilat së bashku me ato të rregjistruara përbëjnë gjithsej 4691 materiale të trajtuara.

Në vitin 2015 janë trajtuar gjithsej 4715 materiale , nga të cilat 1022 proçedime janë mbartur nga viti 2014. Kjo tregon që numëri i materialeve të trajtuara dhe të regjistruara për vitin 2015 është 3553 përkundërt 3825 materialeve të regjistruara në vitin 2016, ku sipas statistikave rezulton që janë rregjistruar 272 materiale më shumë se në vitin 2015.

Ka një përmirësim të punës së prokurorisë referuar mbartjes në numër të materialeve në krahasim me numërin e regjistruar në total dhe atë të mbartur, referuar vitit 2015. Për vitin 2017 nga numëri total i materialeve të trajtuara në vitin 2016, janë mbartur gjithsej 592 proçedime penale dhe 120 materiale të paregjistruara. Pra gjatë 2016-s pavarësisht se janë regjistruar rreth 272 materiale më shumë, janë mbartur më pak materiale. Në raport krahasues me materialet e regjistruara në vitin 2016 ka pasur një rritje të vogël dhe në shifra minimale, me një diferencë prej 18 proçedimesh, por që duke u trajtuar në raport edhe me materialet e mosfilluara ka një rritje me 292 materiale më shumë se viti 2015.

Duke iu referuar treguesve statistikorë për vitin 2016 rezulton se në krahasim me vitin 2015, ka rritje të numërit të materialeve të regjistruara si dhe materialeve të mosfilluara. Konkretisht mosfillime rezultojnë të jenë 1313 materiale kundrejt 1039 të mosfilluara për vitin 2015, pra 274 materiale të mosfilluara më shumë se në vitin 2015.

Vlen të theksohet se ka pasur një fluks kallëzimesh nga shoqëria “TIS Park”, si konçesionare e administrimit të parkimit në qytetin e Vlorës, materiale këto të mosfilluara, të cilat kanë ndikuar në ngarkesën apo numërin më të madh të mosfillimeve për këtë vit. Sqarojmë këtu se ndaj vendimit të mosfillimit për këto raste është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke u lënë në fuqi vendimarrja e organit të akuzës.

Për vitin 2016, ka patur një volum më të madh pune krahasuar me vitet e mëparëshme, si duke ju referuar numrit më të lartë të njoftimeve për vepra penale, ashtu edhe në referencë të numrit të proçedimeve penale të rregjistruara dhe trajtuara gjatë 2016.

Krahasuar këta tregues me vitet, 2014, 2015 sipas tabelës së mëposhtme rezulton:


| Totali i çështjeve të trajtuara |      | Të rregjistruara  | Të mbartura viti parardhës | Seksioni i të Miturve | Çështje të Njesisë (NJ.P.H.) |
|---------------------------------|------|---|----------------------------|-----------------------|------------------------------|
| Viti 2016                       | 4691 | 2532 <sup>1</sup> + 1433 <sup>2</sup><br>(1313 <sup>3</sup> mf) | 726                        | 189                   | 485                          |
| Viti 2015                       | 4715 | 2514+ 1179<br>(1039 mf)   | 1022                       | 205                   | 500                          |
| Viti 2014                       | 3983 | 2458+748 (608 mf)   | 777                        | 218                   | 358                          |

<sup>1</sup> Proçedime të rregjistruara për vitin 2016

<sup>2</sup> Referime që nuk kanë marrë numër proçedimi penal ( mosfilluar + materiale në verifikim 1313 + 120)

<sup>3</sup> Çështje të mosfilluara për vitin 2016

Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm, paraqiten si më poshtë:



| Viti | Totali i çështjeve të trajtuara          | Çështje të përfunduara gjatë vitit | Çështje të mbartura për vitin pasardhës |
|------|--|------------------------------------|---|
| 2016 | $2532^4 + 726^5 + 1313^6 + 140^7 = 4691$ | $2666 + 1313 = 3979$               | 592                                     |
| 2015 | $2514 + 1022 + 1039 + 140 = 4715$        | $2950 + 1039 = 3989$               | 726                                     |
| 2014 | $2458 + 777 + 608 + 140 = 3983$          | $2213 + 608 = 2821$                | 1022                                    |

<sup>4</sup> Proçedime të regjistruara për vitin 2016


<sup>5</sup> Proçedime të mbartura prej vitit 2015

<sup>6</sup> Mosfillime për vitin 2016

<sup>7</sup> Referime që nuk kanë marrë numër (në verifikim)



Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm, paraqiten si më poshtë:



## II/2. Burimet e referimit të çështjeve penale të rregjistruara gjatë vitit 2016.

Përsa i përket burimit të referimit të çështjeve penale të rregjistruara dhe të trajtuara gjatë vitit 2016, është me vend të theksohet se në krahasim me vitin 2015, vihet re një rritje e materialeve të referuara nga shërbimet e policisë gjyqësore, nëpunësit publikë/ institucionet, si dhe rritje e ndjeshme e numrit të kallzimeve nga shtetasit.

Më konkretisht treguesit e burimeve të referimit të çështjeve penale të rregjistruara gjatë vitit 2016 janë:

| Burimi i referimit  | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|------|------|------|------|
| Të rregjistruara kryesisht                                | 34   | 41   | 58   | 38   |
| Kallzime nga nëpunësit publikë/institucionet              | 75   | 64   | 88   | 106  |
| Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit                           | 3    | 2    | 2    | 1    |
| Nga ILDKP   |      | 1    |      | 8    |
| Nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave (FIU) | 7    | 11   | 4    |      |
| Nga Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH)                 | 2    | 4    |      |      |
| Nga Personeli mjekësor                                    |      | 1    |      | 1    |
| Nga Drejtoria e Tatim Taksave + Dogana                    | -    | 1    | 30   |      |

|                                      |     |      |      |             |
|--------------------------------------|-----|------|------|-------------|
| Kallëzime nga shtetas                | 168 | 306  | 251  | 356         |
| Nga policia me vendngjarje           | 835 | 980  | 1214 | 1209        |
| Nga policia me kallëzim të shtetasve | 947 | 1691 | 1927 | 2106        |
| Nga policia pyjore                   | 9   | 17   | -    |             |
| Nga OSSHE                            | 6   | 92   | 95   |             |
| Nga I.N.U.V.-I.N.U.K.                | 19  | 19   | -    |             |
| Të tjera                             |     |      |      | <b>1068</b> |

Referuar statistikave, rezulton se për vitin 2016 ka pasur një rritje të referimeve nga Komisarati i Policisë Vlorë, mbi bazën e kallzimit të shtetasve, me 2106 referime, ndërkohë që konstatohet ulje e referimeve nga Komisarati mbi bazën e vendngjarjeve, me 1209 referime, (ku përkatësisht në këtë drejtim ka pasur shtim të referimeve për nenin 284 të Kodit Penal, me vendngjarje) .

Në raport me vitin 2015 disa institucione si (FIU, SHISH, Drejtoria e Tatim Taksave dhe Dogana, ) nuk kanë kryer referime për vepra penale në këtë fushë, por konstatohet rritje e kallzimeve nga ILDKP, në raport me vitin 2015.

Sipas të dhënave statistikore, rezultojnë që në vitin 2015 të mos ketë pasur referime nga ky institucion, ( ILDKP) ndërsa për vitin 2016 numëri i kallzimeve shkon në 8 (tetë) kallzime penale. Ky trend në rritje për vitin 2016 mendohet të ketë ardhur si rezultat i ndryshimeve dhe reformës në drejtësi.

Po të vërehet me kujdes në tabelën statistikore, rezulton se për vitin 2016 nuk ka pasur referime nga OSHEE, por kjo nuk tregon faktin që gjatë këtij nuk ka pasur hetime mbi veprën penale të ‘Vjedhjes së energjisë elektrike’ pasi referimet janë kryer kryesisht nga Komisarati i Policisë Vlorë, me vendngjarje. Padiskutim që kjo vepër penale , për shkak të ndryshimeve në Kodin Penal , me ligjin nr.98/2014, fluksin më të madh të regjistrimeve e ka pasur në dy vitet e mëparshme 2014-2015, fakt i cili reflektohet me rënie në vitin 2016 për shkak edhe të reflektimit mbi këtë vepër penale. Po kështu edhe përsa i përket veprës penale të “Ndërtimit të paligjshëm” , referimet kanë ardhur si pasojë e njoftimeve nga qytetarë në sallën operative apo përmes kallzimeve të tyre në Komisaratin e Policisë Vlorë.

Këto të dhëna në nivel krahasues me vitet e mëparshme 2014, 2015 janë në nivel më të lartë referues ( referim nga policia) dhe në nivel më të ulët në raport me referime nga institucione të tilla si FIU, SHISH, Doganat e Tatimet, OSHEE.

Përsa i përket “çështjeve penale të rregjistruara kryesisht” këtu janë përfshirë edhe çështjet e rregjistruara mbi bazën e vendimeve të ndarjes së akteve nga çështje të tjera, ndërkohë që nuk ka pasur procedime penale të regjistruara për veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak, madje disa prej tyre kanë qënë të mbartura nga viti 2015.

Në raport me vitin e mëparshëm , rezulton se numri i çështjeve të filluara kryesisht është më i vogël në shifra. Përkrah 58 procedimeve të regjistruara në vitin 2015, në vitin 2016 rezultojnë 38 procedime penale të regjistruara kryesisht, pra rreth 20 procedime penale më pak.

Në këndvështrim të figurave të veprave penale konkrete për të cilat janë rregjistruar procedimet penale, rezulton si më poshtë :


| Numri i procedimeve | Neni për të cilin janë trajtuar |
|---------------------|---------------------------------|
| 40                  | Për nenin 84                    |
| 60                  | Për nenin 89                    |
| 79                  | Për nenin 130/a                 |
| 942                 | Për nenin 134                   |
| 61                  | Për nenin 137                   |
| 14                  | Për nenin 139                   |
| 12                  | Për nenin 141/a                 |
| 33                  | Për nenin 143                   |
| 46                  | Për nenin 150                   |
| 34                  | Për nenin 151                   |
| 12                  | Për nenin 183                   |
| 101                 | Për nenin 186                   |
| 3                   | Për nenin 197                   |
| 43                  | Për nenin 199/a                 |
| 56                  | Për nenin 248                   |
| 30                  | Për nenin 275                   |
| 20                  | Për nenin 277                   |
| 37                  | Për nenin 278                   |
| 77                  | Për nenin 283                   |
| 263                 | Për nenin 284                   |
| 22                  | Për nenin 287                   |
| 70                  | Për nenin 290                   |
| 167                 | Për nenin 291                   |
| 310                 | Për nene të tjera               |

### II/3. Treguesit e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale të trajtuara gjatë vitit 2016.

Gjatë vitit 2016, janë trajtuar një numër i konsiderueshëm procedimesh penale, gjithsej 3979. Prej tyre janë përfunduar gjithsej 2666 procedime, prej të cilave 32% e totalit të çështjeve të përfunduara janë dërguar për gjykim, 16% janë pushuar, 50% janë pezulluar dhe 2% janë dërguar për kompetencë. Janë mbartur për vitin 2017 gjithsej 592 procedime penale, ose 12% e numrit total të çështjeve gjithsej për vitin 2016 (4691).

Më konkretisht treguesit e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale të trajtuara gjatë vitit 2016 duke i krahasuar edhe me të dhënat e viteve 2014, 2015 janë si më poshtë;

\*\*\*




Të dhënat statistikore në formë table:

| <i>Totali i çështjeve</i> |                             | <i>Mosfillim</i> | <i>Pushim</i> | <i>Pezullim</i> | <i>Transferim</i> | <i>Gjykim</i> | <i>Të mbartura për vitin pasardhës</i> |
|---------------------------|-----------------------------|------------------|---------------|-----------------|-------------------|---------------|--|
| <i>Viti 2016</i>          | <i>4551+140<sup>8</sup></i> | <i>1313</i>      | <i>455</i>    | <i>1333</i>     | <i>36</i>         | <i>842</i>    | <i>592 proc+ 120</i>                   |
| <i>Viti 2015</i>          | <i>4575+140</i>             | <i>1039</i>      | <i>518</i>    | <i>1348</i>     | <i>42</i>         | <i>902</i>    | <i>726 proc+140</i>                    |
| <i>Viti 2014</i>          | <i>3843+140</i>             | <i>608</i>       | <i>429</i>    | <i>1038</i>     | <i>42</i>         | <i>704</i>    | <i>1022+140</i>                        |

Nga tabela statistikore rezulton se për vitin 2017, janë mbartur 12.6% të çështjeve totale të trajtuara gjatë vitit 2016, ndërsa për vitin 2016 janë mbartur 15.3% e çështjeve të trajtuara në vitin 2015. Kjo tregon për një punë në progres në krahasim me vitin 2015.

<sup>8</sup> Një pjesë e materialeve të regjistruara në fund të vitit janë në proces verifikimi (140)



Ajo që konstatohet nga të dhënat e mësipërme është fakti se numri i çështjeve penale të dërguara për gjykim është 842 përkundrajt 902 çështjeve të dërguara për gjykim në vitin 2015. Në një këndvështrim të parë konstatohet se në vitin 2015 janë dërguar për gjykim 60 çështje penale më shumë se në vitin 2016, ndërkohë që ka rritje të numrit të materialeve të mosfilluara dhe ulje të numrit të çështjeve të pushuara.

Më konkretisht rezultojnë 274 materiale të mosfilluara më shumë se në vitin 2015 dhe të pushuara janë 63 procedime më pak se në vitin 2015. Po të vërehet në numrin total të çështjeve të regjistruara dhe trajtuara për vitin 2016, konstatohet se është kryer një punë më e mirë në drejtim të vlerësimit të materialit në fazën e kallzimit penal duke shmangur në këtë mënyrë rritjen e numrit të çështjeve të pushuara.

Çështjet e pezulluara sërisht zënë një pjesë të konsiderueshme të procedimeve penale të regjistruara dhe kryesisht i referohen veprave penale të “Vjedhjes” si dhe “Kultivimit të bimëve narkotike”. Vepra penale e vjedhjes ka qënë një trend në rritje përsa i përket krimit ordiner, vjedhjes së celularëve gjatë sezonit turistik, ndërkohë që edhe në rastet e gjetjes së aparatëve celular, provueshmëria e autorësisë së veprës penale ka mbetur e vështirë. Vjedhjet e banesave gjithashtu kanë hasur vështirësi në hetimin e tyre dhe identifikimin e autorëve të tyre, për shkak se jo vetëm që të dëmtuarit nuk kanë pasur dyshime, por edhe krimi ka qënë i sofistikuar në drejtim të kryerjes së tij dhe kujdesit të treguar në mungesën e identifikimit të gjurmëve papilare.

Në lidhje me “Kultivimin e bimëve narkotike” gjithashtu pezullimi i tyre përbën një shqetësim në rritje, për shkak se edhe në rastet e identifikimit të parcelave, ato rezultojnë pa pronar, toka djerrë, ose edhe në rastet e kapjes së punëtorëve në parcela, identifikimi i autorit të saj ka

mbetur i vështirë. Vlen të theksohet se ka pasur raste edhe të identifikimit të pronësisë së parcelës, duke kryer në këto raste një hetim me metoda proaktive, por që gjithsesi kemi hasur në vështirësi për të ngarkuar përgjegjësin penale në këto pak raste.

Në grupin e çështjeve penale të pezulluara, duhet të përmendet edhe një kategori veprash penale që lidhen me “Shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor”. Në mjaft raste pavarësisht mungesës së elementëve të kësaj vepre penale, drejtuesit e mjeteve janë larguar nga vendi i ngjarjes duke iu shmangur përgjegjësisë administrative dhe civile sipas ligjit. Rastet kanë paraqitur vështirësi për shkak të veprimeve hetimore të kryera në momentin e parë, dhe në mungesë edhe të dëshmitarëve okular për identifikimin e mjetit dhe drejtuesit të tyre.

Përsa i përket në numër çështjet penale të pezulluara për vitin 2016 janë 1333 përkundrejt 1348 çështje të pezulluara për vitin 2015, ndërsa të transferuara janë 36 përkundrejt 42 të transferuara në vitin 2015. Kjo kurbë tregon një njëtrajtshmëri të lëvizjes së procedimeve penale të transferuara apo pezulluara, në lëvizje me rreth 10 dhjete materiale.

Vazhdon të jetë i njëjti shqetësim për procedimet e pezulluara, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me veprimet procedurale hetimore të kryera në momentin e parë të marrjes njoftim për veprën penale, kryesisht “Vjedhjes” si dhe me mungesën e koordinimit më njësitë territoriale për çështjet e kultivimit të bimëve narkotike, si vepra që kanë zërin kryesor në kurbën e procedimeve penale të pezulluara.

#### **II/4. Mosfillimet e procedimeve penale gjatë vitit 2016.**

Gjatë vitit 2016 është vendosur mosfillimi i procedimit për 1313 kallzime penale.

Përsa i përket materialeve të mosfilluara vendin kryesor e zënë kallzimet e referuara për veprën penale të “Kanosjes” parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Materialet e referuara për këtë nen kanë qënë kryesisht me referim nga Komisariati i Policisë Vlorë, dhe konfliktet kanë pasur zanafillën në çështjet e pronësisë. Po kështu konfliktet e pronësisë janë shoqëruar gjithashtu edhe me kallzime drejtuar organit të akuzës drejtëpërdrejtë apo në komisarjat për veprën penale të “Shkatërrim prone”, e cila gjithashtu përbën rastet e larta të mosfillimeve të kallzimit penal.

Krahasuar me vitet e mëparshme rezulton se kallzimet për këto dy vepra penale, kanë pasur rritje të ndjeshme dhe konkretisht 20 materiale më shumë për kanosje dhe 129 materiale për veprën penale të “Shkatërrimit të pronës”. Pra në total në raport me numrin e përgjithshëm të mosfillimeve rreth 149 mosfillime janë për këto dy nene, ku baza e konfliktit është çështja e pronësisë.

Një vend të konsiderueshëm në materialet e mosfilluara zënë pikërisht edhe ato që lidhen me veprat penale që ndiqen me ankim ose drejtëpërdrejtë me ankim në gjykatë sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale.

Më konkretisht, treguesit e dosjeve të mosfillimit të procedimeve penale në lidhje me veprat penale të trajtuara janë si më poshtë;

|                        | <i>Viti 2014</i>            | <i>Viti 2015</i>            | <i>Viti 2016</i>            |
|------------------------|-----------------------------|-----------------------------|-----------------------------|
|                        | <i>Numri i mosfillimeve</i> | <i>Numri i mosfillimeve</i> | <i>Numri i mosfillimeve</i> |
| <i>Per nenin 186</i>   | 44                          | 62                          | 59                          |
| <i>Per nenin 90</i>    | 29                          | 88                          | 70                          |
| <i>Per nenin 248</i>   | 74                          | 68                          | 51                          |
| <i>Per nenin 150</i>   | 46                          | 60                          | 189                         |
| <i>Per nenin 143</i>   | 35                          | 57                          | 66                          |
| <i>Per nenin 84</i>    | 42                          | 87                          | 107                         |
| <i>Për nenin 290</i>   | 33                          | 40                          | 63                          |
| <i>Për nenin 99</i>    | 36                          | 70                          | 74                          |
| <i>Për nenin 199/a</i> | 37                          | 51                          | 25                          |
| <i>Për nenin 200</i>   | 21                          | 32                          | 26                          |
| <i>Të tjera</i>        | 211                         | 424                         | 583                         |

Në përgjithësi konstatohet zbatueshmëri dhe respektim i urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me afatin 30-ditor të verifikimit të materialit kallzues para vendimarrjes. Sigurisht që konstatohen raste të tejkalimit të këtij afati, por kjo vërehet më shumë në materialet e referuara për nenin 283, “Prodhim dhe shitje e narkotikëve” në doza të vogla, ku përgjithësisht, ky afat ka qënë për pritje të akteve të ekspertimit toksikologjik. Raste të tjera kanë qënë ato që i referohen nenit 89, 90, për shkak të akteve të ekspertimit mjekoligjor, por të pakta në numër. Kjo shmangie ka qënë për të mos rritur numrin e materialeve të pushuara, si dhe duke analizuar nga afër shkaqet e pajustificuara të materialit për regjistrimin e tij si procedim penal.

Kryesisht këto afate kanë hasur vështirësi në çështjet e krimit ekonomik, ose “Njësisë së Përbashkët Hetimore, Task Forcë”, për shkak të vonesës në kthimin e përgjigjeve nga institucionet përkatëse ku është kërkuar informacion.

## **II/5. Çështjet penale të pushuara gjatë vitit 2016.**

Rezulton se gjatë vitit 2016 është vendosur pushimi për 455 procedime penale, të cilat në krahasim me numrin e procedimeve penale të pushuara në vitin 2015 kanë një rënie në numër. Përkatësisht rezulton që për vitin 2016 të jenë pushuar 455 procedime penale, përkundrajt 518 procedimeve penale të pushuara për vitin 2015. E shprehur në përqindje rezulton se në raport me numrin e çështjeve të trajtuara për vitin 2016, janë pushuar 16% e procedimeve penale, ndërsa për vitin 2015 e shprehur në përqindje rezulton se çështjet e pushuara në raport me ato ta trajtuara janë 18.3%. Pra rezulton të jetë treguar kujdes në vlerësimin e fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit, dhe kujdes në vlerësimin e materialit që në fazën e kallzimit dhe referimit të tij. Në këtë drejtim është kryer një punë e mirë krahasur me vitet e mëparshme.

Mbi bazën e kësaj analize, rezulton një trend në ulje e kurbës së çështjeve të pushuara, e cila nga ana tjetër shoqërohet me rritje të materialeve të mosfilluara, pavarësisht kjo rritjes së numërit të materialeve të regjistruara dhe trajtuara për vitin 2016.

Përsa i përket veprave penale për të cilat është vendosur pushimi i procedimeve penale, numrin më të madh e zënë procedimet penale të regjistruara për veprën penale të “Fallsifikimit të dokumentave” dhe “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 186 dhe 248 i Kodit Penal,

ndërsa në lidhje me veprat penale të “Kanosjes” dhe “Shkatërrimit të pronës” këto çështje zënë një numër më të pakët , për shkak edhe të rritjes së numrit të mosfillimeve për këto dy nene. Ky fakt tregon edhe më shumë kujdesin në vlerësimin e materialit në fazën e referimit dhe kallzimit të tij, për të shmangur rritjen e numrit të çështjeve të pushuara. Në këtë drejtim është kryer një punë pozitive, e kujdesshme, ligjore, gjatë vitit 2016.

Sqarojmë se procedimet penale të pushuara për nenin 186, kryesisht kanë rezultuar si fakte të hetuara më parë, dhe si pasojë e kryerjes së të njëjtit kallzim penal disa herë ndër vite.

Veprat penale për të cilat është vendosur pushimi i procedimeve janë pak a shumë ato për të cilat është vendosur mosfillimi, ndërsa për shkaqet mund të themi se ato përfshijnë rastet e parashikuara më së shumti prej gërmave “b”, “dh” dhe “d” të nenit 328/1 të K.Pr.Penale.

Më konkretisht, treguesit e çështjeve penale të pushuara, në mënyrë krahasimore me vitin 2016, janë si më poshtë :

| <i>Neni</i>            | <i>2013</i> | <i>2014</i> | <i>2015</i> | <i>2016</i> |
|------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| <i>Për nenin 76</i>    | <i>12</i>   |             | <i>1</i>    | <i>1</i>    |
| <i>Për nenin 78</i>    | <i>12</i>   |             |             |             |
| <i>Për nenin 84</i>    | <i>12</i>   | <i>11</i>   | <i>17</i>   | <i>20</i>   |
| <i>Për nenin 89</i>    | <i>30</i>   | <i>54</i>   | <i>32</i>   | <i>19</i>   |
| <i>Për nenin 150</i>   | <i>12</i>   | <i>21</i>   | <i>20</i>   | <i>10</i>   |
| <i>Për nenin 186</i>   | <i>33</i>   | <i>25</i>   | <i>56</i>   | <i>68</i>   |
| <i>Për nenin 199/a</i> | <i>19</i>   | <i>13</i>   | <i>27</i>   | <i>15</i>   |
| <i>Për nenin 248</i>   | <i>24</i>   | <i>32</i>   | <i>31</i>   | <i>47</i>   |
| <i>Për nenin 275</i>   | <i>26</i>   | <i>39</i>   | <i>30</i>   | <i>19</i>   |
| <i>Për nenin 287</i>   | <i>28</i>   | <i>5</i>    | <i>13</i>   | <i>17</i>   |

Nga studimi i grafikut të mësipërm ku pasqyrohen të dhënat statistikore, vërehet se për çështjet penale që ndiqen kryesisht me ankim në gjykatë apo që ndiqen me ankim në bazë të nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht, neni 90, 89, 275, etj rezulton se numri i çështjeve të pushuara ka rënë në krahasim me një vit më parë, tregues ky i kujdesit në fazën e verifikimit të materialit kallzues.

Përsa i përket ligjshmërisë, bazueshmërisë së vendimit dhe arsytimit ligjor të tij, rezulton se, e drejta e ankimit ndaj vendimeve të pushimit të marra nga organi procedues, është ushtruar në 28 raste, vendime këto që janë mbështetur duke u lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor për 22 raste. Rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka pranuar ankmin për 6 raste , duke shfuqizuar vendimet dhe urdhëruar vazhdimin e hetimeve për këto procedime penale.

## **II/6. Çështje penale të dërguara për gjykim gjatë vitit 2016.**

Gjatë vitit 2016 janë dërguar për gjykim 842 procedime penale. Krahasuar me vitin 2015 ka një ulje të procedimeve penale të dërguara për gjykim, por referuar në përqindje në krahasim



me procedimet penale të trajtuara gjatë vitit 2016, ajo është më e lartë se në vitin 2015 me rreth 6%, duke iu referuar procedimeve penale të përfunduara 2666 (2016) me 2827 (2015).

Rezulton se për vitin 2016, ashtu si edhe në vitin 2015, numrin më të madh të çështjeve të dërguara për gjykim e zënë ato të regjistruara për veprën penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Kjo vepër penale është ndjekur këtë vit me ato të dërguara për gjykim për veprën penale të “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, e më tej vend të rëndësishëm në dërgimin e çështjeve në gjykim janë procedimet penale të regjistruara për “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, “Kultivim i bimëve narkotike” dhe “Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 283, 284 dhe 291 i Kodit Penal.

Ajo që vlen të theksohet është se përsa i përket çështjeve penale të dërguara për gjykim për veprën penale të “Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ato janë dërguar kryesisht në 90% të rasteve me gjykim të drejtëpërdrejtë. Raste të pakta janë dërguar me gjykim të zakonshëm, dhe këto procedime lidhen kryesisht me seksionin e të miturve, për shkak jo vetëm të mungesës së arrestit në flagrancë por edhe të faktit që një pjesë e këtyre procedimeve dhe personave në hetim apo të pandehur, kanë qënë nga rrethet.

Po ti referohemi kurbës së të dhënave statistikore, rezulton se në krahasim me vitin 2015, ka pasur rritje prej dy herë më shumë të procedimeve penale të dërguara për gjykim për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal. Ky fakt vlen gjithashtu për veprën penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikëve” ku në këtë rast është rritur numri i personave të pandehur.

Gjatë këtij viti ka pasur një ulje të numërit të procedimeve penale të dërguara për gjykim për veprën penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike” parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal. Në fakt duhet theksuar se referimet për këtë vepër penale, kanë qënë më të pakta në krahasim me vitet e mëparshme, por gjithashtu materialet janë vlerësuar që në fazën e kallzimit të tyre. Një pjesë e këtyre referimeve janë mosfilluar duke analizuar aktet e ekspertimit të HTT, ku gabimi në matës ka qënë i lejuar si dhe mungesën e dëmit të matësit me qëllim vjedhjen e energjisë elektrike. Mendojmë që kjo ka qënë një zgjidhje e drejtë e ndjekur në këto raste, duke mbrojtur, respektuar në mënyrë të tillë të drejtat dhe liritë themelore të njeiut si dhe respektimin e një procesi të drejtë dhe ligjor bazuar në fakte dhe prova duke evituar edhe rastet e pafajësive në gjykatë.

Përsa i përket masave të sigurimit, ajo që është aplikuar më shumë ka qënë kryesisht masa e sigurimit shtrënguese “ Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal. Kjo masë sigurimi është menduar më efikase në rastet e veprave penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore si “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, “Kultivimit të bimëve narkotike”, “ Dhunë në familje”, “Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt”, “ Vjedhje” etj. Pjesa më e madhe e të pandehurve për veprën penale të “Vjedhjes” kanë qënë përsëritës, referuar këtu edhe seksionit të miturve, duke u parë kjo masë shtrënguese më e përshtatshme.

Treguesit e çështjeve penale të dërguara për gjykim janë si më poshtë:

| <i>Nenet</i>                 | <i>Numri i çështjeve të dërguara për gjykim 2014</i> | <i>Numri i çështjeve të dërguara për gjykim 2015</i> | <i>Numri i çështjeve të dërguara për gjykim 2016</i> |
|------------------------------|--|--|--|
| <i>Për nenin 76</i>          | <i>3 – 3 të pandehur – 3 a.burg</i>                  |  | <i>6-11 të pandehur -8a.burg</i>                     |
| <i>Për nenin 78</i>          | <i>1 - 2 të pandehur – 2 a.burg</i>                  | <i>1-1 të pandehur -1a.burg</i>                      | <i>2-4 të pandehur -4a.burg</i>                      |
| <i>Për nenin 79</i>          | <i>3 - 4 të pandehur – 4 a.burg</i>                  | <i>5-6 të pandehur- 6 a.burg</i>                     | <i>1-5 të pandehur- 3 a.burg</i>                     |
| <i>Për nenin 89</i>          | <i>26 – 27 të pandehur</i>                           | <i>34-50 të pandehur</i>                             | <i>38-50 të pandehur</i>                             |
| <i>Për nenin 130/a</i>       | <i>28 – 31 të pandehur – 7 a.burg</i>                | <i>63-67 të pandehur-14 a. Burg</i>                  | <i>57-63 të pandehur-23 a. Burg</i>                  |
| <i>Për nenin 134</i>         | <i>144 – 176 të pandehur – 77 a.burg</i>             | <i>95-180 të pandehur –61 a.burg</i>                 | <i>88-130 të pandehur -74 a.burg</i>                 |
| <i>Për nenin 135</i>         | <i>48 - 48 të pandehur- 10 a.burg</i>                | <i>6-6 të pandehur -5 a.burg</i>                     | <i>5-5 të pandehur -1 a.burg</i>                     |
| <i>Për nenin 137</i>         | <i>5 - 5 të pandehur</i>                             | <i>110-110 të pandehur -15 a. burg</i>               | <i>53-53 të pandehur -2 a. burg</i>                  |
| <i>Për nenin 139-140-141</i> |  | <i>9- 13 të pandehur -11 a.burg</i>                  | <i>4- 6 të pandehur -2 a.burg</i>                    |
| <i>Për nenet 172/174</i>     | <i>5 - 5 të pandehur</i>                             | <i>2-5 të pandehur</i>                               | <i>3-4 të pandehur</i>                               |
| <i>Për nenin 181</i>         | <i>10 – 21 të pandehur – 17 a.burg</i>               | <i>3-3 të pandehur</i>                               | <i>8-11 të pandehur</i>                              |
| <i>Për nenin 186</i>         | <i>16 – 19 të pandehur</i>                           | <i>21-31 të pandehur</i>                             | <i>11-22 të pandehur</i>                             |
| <i>Për nenin 197</i>         | <i>30 – 30 të pandehur</i>                           | <i>13-13 të pandehur</i>                             | <i>5-5 të pandehur</i>                               |
| <i>Për nenin 199/a</i>       | <i>23 – 23 të pandehur – 1 a.burg</i>                | <i>49-49 të pandehur</i>                             | <i>28-32 të pandehur</i>                             |
| <i>Për nenin 248</i>         | <i>11 – 18 të pandehur</i>                           | <i>15-21 të pandehur</i>                             | <i>11-14 të pandehur</i>                             |
| <i>Për nenin 259</i>         | <i>2 - 3 të pandehur – 1 a.burg</i>                  | <i>2-5 të pandehur -2 a.burg</i>                     |  |
| <i>Për nenin 275</i>         | <i>1 - 1 të pandehur</i>                             | <i>5-5 të pandehur</i>                               | <i>4-4 të pandehur</i>                               |
| <i>Për nenin 278</i>         | <i>25 – 25 të pandehur – 20 a.burg</i>               | <i>24-25 të pandehur -24 a.burg</i>                  | <i>22-31 të pandehur -26 a.burg</i>                  |
| <i>Për nenin 283</i>         | <i>16 – 18 të pandehur – 8 a.burg</i>                | <i>36-51 të pandehur-30 a.burg</i>                   | <i>44-66 të pandehur-55 a.burg</i>                   |
| <i>Për nenin 284</i>         | <i>6 - 6 të pandehur – 3 a.burg</i>                  | <i>19-19 të pandehur-12 a.burg</i>                   | <i>35-42 të pandehur-26 a.burg</i>                   |
| <i>Për nenin 287</i>         | <i>1 – 2 të pandehur</i>                             | <i>3- 4 të pandehur</i>                              | <i>2- 4 të pandehur</i>                              |
| <i>Për nenin 290</i>         | <i>19 - 19 të pandehur – 6 a.burg</i>                | <i>20-20 të pandehur-3 a.burg</i>                    | <i>31-31 të pandehur-17 a.burg</i>                   |
| <b><i>Të tjera</i></b>       | <b><i>369</i></b>                                    | <b><i>364</i></b>                                    | <b><i>384</i></b>                                    |

Duke qënë se disa prej veprave penale të mësipërme, kanë qënë fenomen shqetësues në rreth, janë bërë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim edhe me policinë gjyqësore, për t'i kushtuar rëndësinë e duhur çështjeve penale që kanë lidhje me veprat e mësipërme, me qëllim që hetimet paraprake në lidhje me këto vepra të jenë sa më të plota, të kryhen në afate optimale dhe të rritet zbulueshmëria për të vënë para përgjegjësisë penale autorët të cilët janë burim rreziku për shoqërinë.

## **II/7. Çështjet penale të pezulluara gjatë vitit 2016**

Vazhdon që numri i procedimeve penale të pezulluara të përbëjë pjesën më të madhe të procedimeve penale të trajtuara gjatë vitit 2016. Ky është një shqetësim i cili ka qënë prezent edhe në vitet e mëparshme, ku ky trend zë rreth 30-40 % të procedimeve penale. Rezulton se gjatë vitit 2016 janë pezulluar për moszbulim të autorëve të veprës penale 1333 procedime penale, i cili krahasuar me vitin 2015, treguesit janë pothuajse në nivele të njëjta. Konkretisht në numër janë 1333 procedime për vitin 2016 përkundrejt 1348 procedime të pezulluara për vitin 2015.

Më konkretisht, treguesit e çështjeve penale të pezulluara në lidhje me veprat penale të trajtuara në to paraqiten si më poshtë;

| <i>Vepra penale</i>         | <i>Viti 2014</i> | <i>Viti 2015</i> | <i>Viti 2016</i> |
|-----------------------------|------------------|------------------|------------------|
| <i>Për nenin 78 të K.P.</i> | 3                | 3                | 1                |
| <i>Për nenin 134</i>        | 734              | 905              | 867              |
| <i>Për nenin 150</i>        | 36               | 25               | 22               |
| <i>Për nenin 151</i>        | 25               | 44               | 36               |
| <i>Për nenin 283</i>        | 8                | 12               | 9                |
| <i>Për nenin 284</i>        | 120              | 151              | 235              |
| <i>Të tjera</i>             | 112              | 208              | 163              |

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se numri i çështjeve penale të rregjistruara dhe të pezulluara për nenin 134 të Kodit Penal është i konsiderueshëm dhe rritja e kësaj figure bazohet në faktorë socialë dhe ekonomikë. Ashtu sic është theksuar edhe më lart, këto vepra penale i referohen kryesisht vjedhjeve të banesave, celularëve, (shtim ky në numër gjatë sezonit turistik), ku identifikimi i autorëve është bërë i vështirë për shkak edhe të mungesë së gjurmëve, apo qoftë edhe mungesës së dyshimeve për persona konkret. Kjo tregon se autorët e kryerjes së këtyre veprave penale, kanë arritur përsosjen e nivelit të kryerjes së krimit, hyrjes në banesa, apo vjedhjes ordinere të hapur të celularëve, duke përvetësuar më pas sendin e vjedhur, e cila bën të pamundur qoftë edhe me tabulate telefonike në identifikimin e autorësisë së këtyre veprave.

Gjithashtu shqetësues mbetet edhe pezullimi i procedimeve penale për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” i cili si edhe pasqyrohet në tabelën statistikore zë një pjesë të konsiderueshme në numërin e çështjeve penale të trajtuara gjatë këtij viti. Vlora paraqitet problematike në këtë drejtim, me një pasqyrim të gjerë kësaj vepre penale, ku ndikojnë shumë faktorë ekonomikë, sociale, sic është pozita gjeografike që ajo ka. Në këtë drejtim duhet që të ketë një bashkëpunim të theksuar midis strukturave policore me njësitë territoriale si dhe qytetarët për denoncimin dhe identifikimin jo vetëm të parcelave por edhe të autorëve të tyre.

Pezullimi i këtyre procedimeve penale vjen kryesisht si pasojë e faktit të mosidentifikimit të pronësisë së parcelave ku konstatohet lënda narkotike, për shkak se përdoren toka djerrë apo të hapura rishtazi. I vështirë në këtë drejtim ka qënë edhe përdorimi i metodave proaktive të hetimit, për shkak të zonave të thella ku ato janë të pozicionuara.

Duhet theksuar se përsa i përket referimeve të ësjaj vepre penale, për vitin 2016, janë referuar një numër më i lartë materialesh, në krahasim me vitet e mëparshme, fakt ky që ka sjell edhe shtimin e procedimeve penale të pezulluara për këtë vepër penale.

Treguesit në rritje të procedimeve penale të pezulluara, janë të lidhura ngushtësisht me cilësinë e materialeve referues dhe posaçërisht me veprimet e para hetimore. Për të përmirësuar këta tregues duhet një kujdes i veçantë nga policia gjyqësore në këqyrjet e vendit të ngjarjes. Duhet gjetur rrugë e mënyra të ndryshme, për të afruar informacionin e nevojshëm për autorët

dhe gjetjen e mjeteve e metodave ligjore për të kthyer në prova të gjitha të dhënat që administron policia gjyqësore për rastin.

Në shumë raste, veprimet e para hetimore, si kqyrja e vendit të ngjarjes, zbulimi, fiksimi dhe marrja e gjurmëve dhe provave materiale që kanë lidhje me zbulimin e mekanizmit dhe autorëve, kanë qenë jo të plota dhe të kryera në mënyrë jo profesionale. Kryerja e ketyre veprimeve me përpikmëri dhe përgjegjësi do të çonte në hetimin e plotë të ngjarjes dhe zbulimin dhe vënien para përgjegjësive penale të autorëve të kryerjes së veprës.

## **II/8. Çështjet penale të transferuara gjatë vitit 2016.**

Rezulton se gjatë vitit 2016 është shpallur moskompetenca për 36 procedime penale, kryesisht për mungesë kompetencë territoriale dhe lëndore. Ka pasur raste të shpalljes së moskompetencës edhe për një autor të dyshuar për disa vepra penale, duke i kaluar çështjen për hetim një prokurorie.

Përgjithësisht nuk ka pasur raste të konfliktit të kompetencave, përse i përket shpalljes së moskompetencës territoriale. Në një rast, kur nga ana e organit proçedues është shpallur moskompetenca lëndore dhe çështja është dërguar për hetim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nga ana e kësaj të fundit çështja është ridërguar pranë Prokurorisë Vlorë, dhe nga ana jonë është bërë konflikt kompetence , duke u mbështetur vendimarrja jonë nga Prokuroria e Përgjithshme.

## **II/9. Treguesit e të pandehurëve**

Gjatë vitit 2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, janë marrë në cilësinë e të pandehurit 1152 persona dhe 291 shtetas në cilësinë e personit nën hetim, nga të cilët 1044 shtetas janë dërguar për gjykim me akuzat përkatëse , pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën statistikore, është i konstatueshëm fakti se për vitin 2016 numri i të pandehurve është 1044 përkundrajt 1076 të pandehurve në vitin 2015, pra rreth 32 të pandehur më pak, ndërsa përse i përket masave të sigurimit me të cilat këta shtetas janë hetuar apo dërguar për gjykim rezulton se për vitin 2016 numri i tyre është 381, pra rreth 100 persona në hetim me masë sigurimi arrest në burg, më shumë se në vitin 2015. Në këtë drejtim të aplikimit të masës së sigurimit shtrënguese, ka ndikuar edhe shtimi i referimeve dhe arrestimeve për veprën penale të “Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt” ku pavarësisht se masa e sigurimit ka qenë ajo shtrënguese, këto çështje janë dërguar gjithashtu me gjykim të drejtëpërdrejtë.

Më konkretisht, treguesit e të pandehurve për vitet 2016 dhe 2015 janë si më poshtë:

| Viti | Të pandehur     | P.në hetim | Pushuar            | Transferuar      | Pezulluar | Gjykim             |
|------|-----------------|------------|--------------------|------------------|-----------|--------------------|
| 2016 | 1152-434 a.burg | 291        | 63<br>p.hetim      | 9<br>p.hetim     |           | 1044-381<br>a.burg |
| 2015 | 1213-335 a.burg | 410        | 3+118<br>p.hetim   | 6+18<br>p.hetim  |           | 1076-268<br>a.burg |
| 2014 | 1064-362-arrest | 377        | 6+97<br>p.hetim    | 12+17<br>p.hetim | 3 p.hetim | 805-226<br>a.burg  |
| 2013 | 988- 320 arrest | 356        | 7 + 105<br>p.hetim | 9 + 3<br>p.hetim | -         | 753- 240<br>a.burg |

## II/10. Treguesit e masave të sigurimit.

Gjatë vitit 2016, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë referuar në funksion të procedimeve penale të regjistruara 449 raste të personave të arrestuar në flagrancë apo ndaluar. Për personat e arrestuar dhe ndaluar, nga ana e prokurorëve është urdhëruar lirim i menjëhershëm në 8 raste, dhe në 441 raste janë dërguar aktet në gjykatë për vleftësim arresti në flagrancë/ndalimi dhe është kërkuar në 368 raste caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” dhe kërkesë e pranuar nga gjykata në 299 raste. Për rastet e tjera gjykata ka caktuar si masë sigurimi “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, “Arrest në shtëpi”.

Përsa i përket rasteve kur është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në burg” përgjithësisht, janë rastet e procedimeve penale të regjistruara për nenin 291 të Kodit Penal, kur së bashku me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit është kërkuar edhe gjykimi i drejtëpërdrejtë i saj. Në fakt gjykata në këto raste ka pasur dy qëndrime në caktimin e masës së sigurimit, duke aplikuar arrest në burg të altenuar me detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore. Ndoshta qëndrimi i gjykatës në aplikim të masës së sigurimit detyrim për paraqitje ka qënë ngushtësisht i lidhur edhe me masën e dënimit të dhënë prej saj, duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal apo edhe atë të kryerjes së një pune publike, sipas nenit 63 të Kodit Penal. Theksohet këtu se përsa i përket konsumimit të kësaj vepra penale nga të miturit, ata ose janë ndjekur në gjëndje të lirë ose me masë sigurimi detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore.

Po kështu duke iu referuar faktit se numërin më të madh të çështjeve të dërguara për gjykim e zë pikërisht vepra penale e “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, për këto raste qëndrimi i gjykatës ka qënë mbështetës në zbatimin e masës së sigurimit shtrënguese arrest në burg.

Masat e sigurimit si “Arrest në shtëpi” apo masë sigurimi “me afat”, është aplikuar kryesisht nga organi procedues në raste e veprave penale të regjistruara për nenin 290 të Kodit Penal, kur është vlerësuar se duhet të administrohet akti ekspertimi mjekoligjor, apo në disa raste të rralla edhe akti i ekspertimit autoteknik. Në lidhje me lirimet e menjëhershme gjithashtu bëhet fjalë për veprat penale të regjistruara për nenin 290 “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”. Në fakt në këto raste është urdhëruar lirimi që në fazën e parë të hetimit, sapo është vënë në dispozicion të organit procedues referimi mbi arrestimin e kryer.

Përsa i përket masave të sigurimit “Arrest në burg në mungesë” ato janë kërkuar nga organi i akuzës për veprat penale të “Mashttrimit” parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, për veprën penale të “Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal si dhe në rastet e ‘Kultivimit të bimëve narkotike’ parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal. Këto kërkesa janë mbështetur nga gjykata në të gjitha rastet që janë kërkuar.

Në analizë sa më sipër rezulton se në rreth 80% të rasteve është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në burg”, ndërsa në 13% të rasteve masa e sigurimit “Detyrim për paraqitje” dhe pjesa tjetër masa të tjera sigurimi. Gjykata rezulton të na ketë mbështetur në 67 % të rasteve për kërkesën tonë në lidhje me masën e sigurimit “Arrest në burg”.

Treguesit e masave të sigurimit, referuar edhe qëndrimeve që ka mbajtur gjykata, flasin për një politikë të drejtë të ndjekur nga prokuroria në lidhje me caktimin e masave të sigurimit. Kujdes i veçantë është treguar në rastet kur personat e dyshuar kanë qënë të mitur, pasi në lidhje me ta veç moshës janë mbajtur parasysh edhe rrethana të tjera shoqërore e sociale për të qënë sa më objektiv e të kujdesshëm në caktimin e masës së sigurimit.

Treguesit e masave të sigurimit janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

| <i>Totali i arrestimeve/ndalimeve</i> | <i>Lirim i menjëhershëm<br/>Neni 257</i> | <i>Kërkesa e prokurorisë<br/>Neni 258</i> | <i>Vendimi i gjykatës<br/>Neni 259</i> |
|---------------------------------------|--|---|--|
| 449                                   | 8  | 441                                       | 441                                    |
| <i>Vleftësime të ligjshme</i>         |  | 441                                       | 339                                    |
| <i>Vleftësime të paligjshme</i>       |  |   | 2                                      |
| <i>Arrest në burg</i>                 |  | 368                                       | 299                                    |
| <i>Arrest me afat</i>                 |  | 12  | 19                                     |
| <i>Arrest në shtëpi</i>               |  | 2   | 9                                      |
| <i>Detyrim paraqitje</i>              |  | 58  | 108                                    |
| <i>Garanci pasurore</i>               |  |   |  |
| <i>Arrest në mungesë</i>              |  | 6   | 6                                      |

### III. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS.

#### III/1. Treguesit e efektivitetit në gjykim dhe dënime.

Gjatë vitit 2016, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë përfunduar gjykimet e 842 çështjeve penale me 1006 të pandehur. Nga totali i çështjeve të gjykuara, nga ana e organit të prokurorisë gjatë vitit 2016, është kërkuar dënimi i të pandehurve me gjobë në 182 raste, tërheqje aktesh në 9 raste, pushim çështje në 17 raste, në rastet e tjera është kërkuar dënim me burgim. Në 4 raste burgim i përjetshëm, në 1 rast ulje dënimi nën minimum. Janë gjithsej 148 raste me kërkesë për dënim me kusht, të cilat i referohen më së shumti rasteve me të pandehur të mitur, për arsye të politikës së ndjekur për këtë kategori personash.

Përsa i përket qëndrimit të mbajtur nga gjykata në rastet e dhënies së dënimit, duhet theksuar se kërkesa e prokurorisë për dënime me burgim është mbështetur nga gjykata në 70% të rasteve, ndërsa pjesa tjetër ku gjykata shpesh nuk i ka qëndruar kërkesës së prokurorisë lidhet pikërisht me gjykimet e drejtëpërdrejta për nenin 291 të Kodit Penal, ku qëndrimi i saj ka qënë aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, pra pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim. Ky qëndrim i saj është mbështetur edhe nga gjykata e Apelit, cka tregon që në këtë drejtim duhet të tregohet kujdes përsa i përket masës dhe llojit të dënimit të kërkuar për këtë kategori veprash penale.

Në lidhje me mbështetjen e qëndrimit të organit të akuzës për dënimin me gjobë, gjykata ka pranuar atë pothuajse në 90% të rasteve të kërkuara, qëndrim ky i cili ka gjetur mbështetje edhe në kërkesat e prokurorisë për dënime maksimale, veçanërisht për vepra penale të rënda.

Pafajsitë si një shqetësim i dukshëm, paraqiten për kategori veprash penale si “ Shpërdorim detyre”, “Vjedhje e energjisë elektrike”, “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”. Në drejtim të veprës penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike” ashtu si është trajtuar edhe më lart, këto materiale kanë filluar të trajtohen me kujdes, duke iu referuar edhe aktit të konstatimit apo raportit HTT, dhe është munduar të merret vendim mosfillimi kur gabimi në matës ka qënë i lejuar, duke shmangur pafajsitë. Një pjesë e proçedimeve penale për të cilat janë marrë pafajsi rezultojnë të jenë regjistruar dhe dërguar për gjykim gjatë vitit 2015, pasi këtë vit (referuar këtu 2016) këto vepra penale jo vetëm që kanë qënë më të paktë në numër por edhe si u sqarua më lart një pjesë janë mosfilluar.


Nga të dhënat statistikore rezultojnë se për vitin 2016 ka pasur një rritje të ndjeshme të çështjeve që janë dërguar me gjykim të drejtëpërdrejtë, (shif tabelën dhe grafikun më poshtë) krahasuar kjo me një vit më parë. Konkretisht nga organi i akuzës për këtë vit janë dërguar me gjykim të drejtëpërdrejtë 121 proçedime penale me 122 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2015 janë dërguar 67 proçedime me 71 të pandehur. Ky është një tregues pozitiv, në punën e prokurorisë dhe të prokurorëve, në vlerësimin e menjëhershëm të materialit, shpejtësinë dhe korrektësinë në moszvarritjen e çështjeve penale. Faktikisht referuar statistikave, numri më i madh i çështjeve me gjykim të drejtëpërdrejtë lidhet me veprën penale të “Drejtimin të mjetit në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, dhe duke mos lënë jashtë kësaj edhe çështje të regjistruara për veprën penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal si dhe pak raste janë vepra penale “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.

\*\*\*

Më konkretisht treguesit e gjykimit të çështjeve penale janë si më poshtë;

| Viti | Totali i çështjeve të gjykuara | Gjykim i drejtëpërdrejtë | Gjykim i shkurtuar | Gjykim i zakonshëm | Gjykim në mungesë |
|------|--------------------------------|--------------------------|--------------------|--------------------|-------------------|
| 2016 | 835 - 1006 të pandehur         | 121 - 122                | 580 - 710          | 92 - 120           | 42 - 54           |
| 2015 | 719 - 880 të pandehur          | 67 - 71                  | 607 - 750          | 34 - 45            | 11 - 14           |

Treguesit e mësipërm paraqiten në grafikën që vijon:



Të dhënat mbi llojet dhe masat e dënimit paraqiten në tabelën si më poshtë:

| Llojet e dënimeve          | Kërkesa e prokurorisë | Vendimi i gjykatës |
|----------------------------|-----------------------|--------------------|
| Dënim me gjobë             | 182                   | 175                |
| Dënim me burgim (mesatar)  | 624                   | 428                |
| Dënim me burgim (maksimal) | 10                    | 7                  |
| Paraburgim                 | 11                    |                    |
| Ulje dënimi nën minimum    | 1                     | 1                  |
| Pezullim ekzekutimi dënimi | 148                   | 310                |
| Burgim të përjetshëm       | 4                     | 3                  |
| Tërheqje aktesh            | 9                     | 9                  |
| Pushim çështje             | 17                    | 23                 |
| Pafajësi                   |                       | 57                 |



Gjatë vitit 2016 pafajësitë janë marrë për veprat penale të mëposhtme:

|             |       |            |
|-------------|-------|------------|
| - Për nenin | 88    | 1 pandehur |
| - Për nenin | 89    | 2 pandehur |
| - Për nenin | 106   | 1 pandehur |
| - Për nenin | 114/1 | 2 pandehur |
| - Për nenin | 130/1 | 1 pandehur |
| - Për nenin | 130/a | 4 pandehur |
| - Për nenin | 134   | 4 pandehur |
| - Për nenin | 137   | 6 pandehur |
| - Për nenin | 143   | 2 pandehur |
| - Për nenin | 175   | 1 pandehur |
| - Për nenin | 186   | 3 pandehur |
| - Për nenin | 199/a | 3 pandehur |
| - Për nenin | 200   | 1 pandehur |
| - Për nenin | 236   | 2 pandehur |
| - Për nenin | 238   | 1 pandehur |
| - Për nenin | 242   | 4 pandehur |
| - Për nenin | 247   | 1 pandehur |
| - Për nenin | 248   | 9 pandehur |
| - Për nenin | 283   | 5 pandehur |
| - Për nenin | 284   | 2 pandehur |
| - Për nenin | 300   | 2 pandehur |
| - Për nenin | 316   | 1 pandehur |

Për shumë nga rastet e pafajësive vazhdojmë të mbetemi konstant në qëndrimet tona para gjykatës sigurisht duke analizuar çdo qëndrim apo kërkesë tonën , dhe çdo qëndrim apo arsyetim të gjykatës, në mënyrë të tillë që ti japim mbështetjen dhe vëmendjen e duhur çdo rasti dhe praktike në respektim të mbrojtjes të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Për të gjitha rastet është mbajtur qëndrimi ligjor duke ankimuar vendimet e gjykatës.

### **III/2. Treguesit e ngarkesës për Seksionin e të Miturve gjatë vitit 2016.**

Gjatë vitit 2016 Seksioni i të Miturve ka patur në përbërje të tij vetëm një prokurorë , Dritan Markun si dhe oficerin e policisë gjyqësore Skerdilajd Qinami, i cili më pas është zëvendësuar me oficerin e policisë gjyqësore Avni Begaj.

Seksioni i të Miturve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, përfshin në juridiksionin e tij çështjet penale të disa rretheve, konkretisht Skraparit, Beratit, Lushnjës dhe Fierit. Pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, janë regjistruar për vitin 2016; 189 procedime penale me të mitur. Gjithsej kanë qënë 157 të mitur në hetim nga të cilat janë

dërguar për gjykim, duke u marrë në cilësinë e të pandehuit 138 prej tyre dhe nga gjykata është dhënë vendim për 114 të pandehur.

Në lidhje me masat e sigurimit, rezulton se 30 prej tyre janë ndjekur me masë sigurimi “Arrest në burg”; 19 me masë sigurimi detyrim për paraqitje, kërkesa këto që janë pranuar nga gjykata, duke ndryshuar qëndrimin në një rast dhe caktuar si masë sigurimi atë të garancisë pasurore.

Nga ana e organit të akuzës është mbajtur parasysh në caktimin e dënimit për të miturit të gjitha konventat, ligjet, udhëzimet, në lidhje me kujdesin që duhet të tregohet ndaj tyre. Kërkesat e organit procedues kanë qënë 19 për masën e dënimit gjorbë, 6 janë në minimum, 17 janë masa dënimi mesatare dhe 72 janë kërkuar dënime alternative. Gjykata gjithashtu edhe në këto raste ka mbështetur qëndrimin tonë, duke aplikuar dënimin alternativ në 77 raste nga 72 që janë kërkuar nga organi i prokurorisë. Ky seksion gjatë vitit 2016 ka hetuar dhe gjykuar një numër të konsiderueshëm çështjesh penal ku pjesa më e madhe e tyre u janë referuar nga rrethet e tjera gjyqësore.

Në çështjet që ka trajtuar seksioni i të miturve kujdes i veçantë i është kushtuar caktimit të masave të sigurimit. Gjithashtu edhe në kërkesat për masë dënimi është mbajtur parasysh fakti se subjektet janë persona të mitur dhe lloji dhe masa e dënimit të dhënë ka qënë gjithnjë e kushtëzuar nga ky fakt dhe sigurisht ka patur për bazë parashikimet ligjore për veprën e kryer. Qëndrim i ashpër është mbajtur për të miturit që kanë rezultuar përsëritës dhe për rastet kur vepra është kryer në rrethana të cilësuar.

Më konkretisht treguesit e ngarkesës së punës së Seksionit të të Miturve janë si më poshtë:

| Viti | Totali çështje | Çështje të Vlorës | Çështje të rretheve | Mosfillim | Pushim | Pezullim | Transf. | Gjykim | Të mbartura |
|------|----------------|-------------------|---------------------|-----------|--------|----------|---------|--------|-------------|
| 2016 | 189            | 40                | 149                 | 35        | 22     | -        | -       | 122    | 10          |
| 2015 | 205            | 36                | 139                 | 18        | 9      | 10       | 6       | 136    | 25          |

Ajo që vihet re në trajtimin e çështjeve penale me të mitur është fakti se pjesa më e madhe e çështjeve të rregjistruara kanë qënë kryesisht për veprën penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal si dhe “Drejtimit mjeteve në mënyrë të pa rregull”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Ndërkohë që në ndryshim nga vitet e kaluara në vitin 2016 janë rregjistruar dhe procedime penale për veprat penale në fushën e krimeve seksuale me të mitur, por dhe në atë të kultivimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike, në sasira të vogla, për të cilat është marrë vendim mosfillimi.

### III/3. Shpejtësia në hetime dhe zgjatja e afatit të hetimeve paraprake gjatë vitit 2016.

Gjatë vitit 2016 rezulton se për çështjet që janë trajtuar nga organi i prokurorisë janë marrë zgjatje e afatit të hetimeve paraprake për 131 çështje me 169 persona në hetim apo të pandehur nga të cilët, 32 kanë qënë me masë sigurimi “arrest në burg”. Nga këto zgjatje afati, 69 janë bërë vetëm me 3 (tre) muaj, 50 janë bërë nga 3-6 muaj, 13 raste nga 6-9 muaj.

Rrethanat që kanë sjellë në zgjatje të afatit të hetimeve lidhen kryesisht me ndryshimet strukturore të policisë gjyqësore, vonesat në administrimin e akteve dhe informacioneve të tjera nga institucionet, vështirësi në saktësimin e adresave dhe gjetjen e personave që pyeten etj.

Si shkak specifik për vitin 2016, përsa i përket zgjatjes së afatit të hetimeve, renditen edhe vonesat në kryerjen e ekspertimeve kryesisht ato biokimike pranë D.P.SH.Tiranë, duke përmendur këtu rastet për veprat penale të “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, ku vonesat e ekspertimit kimik të bimës narkotike ka vonuar, mbi tre muaj. Ky shqetësim është i dukshëm edhe në veprat penale të regjistruara për “Kultivimin e bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal.

#### **III/4. Shfuqizimet e akteve të prokurorëve gjatë vitit 2016.**

Gjatë vitit 2016 rezultojnë të jenë shfuqizuar nga prokurori më i lartë 17 çështje penale, nga të cilat 11 janë shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe 6 nga Prokurori i Përgjithshëm.

Procedimet penale të shfuqizuara nga Drejtuesi i Prokurorisë, kanë qënë kryesisht për veprime hetimore shtesë, kualifikim jo të drejtë të veprës penale, apo edhe për shkelje proceduriale. Në një rast vendimi i shfuqizimit është ankimuar tek Prokurori i Përgjithshëm, nga ku është lënë në fuqi vendimi i shfuqizimit të Drejtuesit të Prokurorisë. Për rastet e tjera, kanë vijuar hetimet duke respektuar detyrat konkrete të lëna në vendimin e shfuqizimit.

#### **III/5. Përgjimet**

Përgjimi si mjet për kërkimin e provës, është përdorur kryesisht në rastet e hetimeve për veprat penale që lidhen me kultivimin e bimëve narkotike apo prodhimin dhe shitjen e saj. Pjesa më e madhe e përgjimeve janë autorizuar në momentin e parë nga prokurori i çështjes duke kërkuar më pas vlerësimin dhe lejimin e tij në gjykatë. Gjykata ka mbajtur qëndrime në favor të organit proçedues, duke përjashtur disa raste kur ky përgjim nuk është miratuar. Në këto raste është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë, duke u mbështetur vendimi i prokurorit.

Duhet theksuar se janë të pakta rastet kur përgjimi është kërkuar që në fillim me kërkesë në gjykatë, kjo për shkak se ngjarjet kanë qënë të ngutshme, flagrante dhe kjo ka shtuar mundësinë që ky përgjim të jetë i menjëhershëm nga prokurori i çështjes.

Gjithashtu përgjimi është autorizuar në rastet e vepra penale të rënda si vrasje, plagosje të rënda, etj, pra krime kundër jetës dhe shëndetit të personit, qoftë për vendosjen e të dyshuarit, qoftë për identifikimin e tij.

Ajo që vlen të theksohet është përdorimi i përgjimit në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, si mjet i suksesshëm në kapjen e autorëve të dënuar për vepra penale të rënda.

### **III/6. Apelimet e bëra nga Prokuroria gjatë vitit 2016.**

Gjatë vitit 2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka paraqitur në gjykatë në total 207 ankime për vendime themeli të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe 60 apele kundërshtuese.

Për ushtrimin e të drejtës së ankimit është mbajtur parasysh Urdhëri i Prokurorit të Përgjithshëm. Kështu pjesa më e madhe e ankimeve janë për vendimet e pafajësisë së plotë apo të pjesshme të dhënë nga gjykata si dhe për rastet e ndryshimit të cilësimit të veprës penale. Gjithashtu është ushtruar e drejta e ankimit edhe në rastet kur ka patur diferenca midis sanksioneve të kërkuara nga prokurori me ato të vendosura nga gjykata.

Ka patur një bashkërendim të mirë të punës me Prokurorinë e Apelit Vlorë në lidhje me problematikat e hasura gjatë gjykimit të çështjeve duke unifikuar qëndrimet dhe rakorduar praktikat për rastet e ngjashme.

\*\*\*

#### IV. NGARKESA E PUNËS SË PROKURORËVE DHE OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE GJATË VITIT 2016.

Gjatë vitit 2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka pasur një ngarkesë të konsiderueshme si përsa i përket hetimit ashtu edhe përfaqësimit të çështjeve në gjykim.

Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur të dhënat e ngarkesës së prokurorëve në fazën e hetimeve paraprake dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve prej tyre.

| <i>Nr.</i>          | <i>Prokuror</i>     | <i>Gjithsej</i> | <i>Mos.</i> | <i>Pushim</i> | <i>Pezullim</i> | <i>Tranf</i> | <i>Gjyq.</i> | <i>Bashkuar</i> | <i>Hetim</i> |
|---------------------|---------------------|-----------------|-------------|---------------|-----------------|--------------|--------------|-----------------|--------------|
| 1                   | <i>R.Troci</i>      | 3               | 2           | 1             | 0               | 0            | 0            | 0               | 2            |
| 2                   | <i>F.Çela</i>       | 83              | 22          | 9             | 38              | 4            | 21           | 0               | 10           |
| 3                   | <i>A.Xhaferraj</i>  | 63              | 14          | 12            | 18              | 3            | 14           | 3               | 13           |
| 4                   | <i>A.Ismailukaj</i> | 9               |             |               | 7               | 1            |              |                 |              |
| 5                   | <i>A.Kulifi</i>     | 125             | 35          | 51            | 5               | 4            | 25           | 5               | 35           |
| 6                   | <i>A.Pali</i>       | 114             | 55          | 5             | 27              | 0            | 30           | 10              | 42           |
| 7                   | <i>A.Safiu</i>      | 208             | 69          | 27            | 100             | 0            | 53           | 3               | 25           |
| 8                   | <i>A.Zarqa</i>      | 202             | 94          | 14            | 90              | 2            | 48           | 0               | 48           |
| 9                   | <i>D.Marku</i>      | 242             | 51          | 32            | 22              | 3            | 143          | 11              | 31           |
| 10                  | <i>E.Alvora</i>     | 210             | 100         | 29            | 115             | 1            | 42           | 5               | 18           |
| 11                  | <i>E.Çela</i>       | 200             | 112         | 23            | 102             | 2            | 47           | 3               | 23           |
| 12                  | <i>E.Laze</i>       | 201             | 91          | 9             | 116             | 1            | 54           | 2               | 19           |
| 13                  | <i>E.Mustafaj</i>   | 135             | 48          | 30            | 8               | 9            | 25           | 12              | 51           |
| 14                  | <i>E.Shqarri</i>    | 216             | 82          | 31            | 104             | 1            | 54           | 0               | 26           |
| 15                  | <i>H.Lamaj</i>      | 213             | 102         | 26            | 117             | 0            | 52           | 1               | 17           |
| 16                  | <i>K.Braho</i>      | 3               |             | 1             | 2               |              |              |                 |              |
| 17                  | <i>K.Llaho</i>      | 156             | 38          | 57            | 8               | 1            | 26           | 11              | 53           |
| 18                  | <i>M.Sota</i>       | 189             | 108         | 19            | 89              | 1            | 55           | 4               | 21           |
| 19                  | <i>S.Dautaj</i>     | 43              | 17          | 4             | 25              | 1            | 13           | 0               | 0            |
| 20                  | <i>S.Lule</i>       | 15              |             | 11            |                 | 4            |              |                 |              |
| 21                  | <i>S.Smaqa</i>      | 236             | 86          | 32            | 107             | 0            | 63           | 5               | 29           |
| 22                  | <i>V.Mata</i>       | 168             | 83          | 17            | 95              | 0            | 32           | 5               | 19           |
| 23                  | <i>Xh.Saliaj</i>    | 224             | 92          | 27            | 127             | 2            | 41           | 2               | 27           |
| <b><i>SHUMA</i></b> |                     | <b>3258</b>     | <b>1313</b> | <b>445</b>    | <b>1333</b>     | <b>36</b>    | <b>842</b>   | <b>82</b>       | <b>510</b>   |

Krahasuar me vitin 2015 rezulton se ngarkesa për çdo prokuror ka një mesatare më të lartë, referuar kjo edhe organikës përkatëse. Në vitin 2015 kanë ushtruar funksionet e tyre 27 prokurorë, ndërkohë që në vitin 2016, kanë qënë 23 prokurorë, çka tregon se numri përgjithshëm i procedimeve të trajtuara nga një prokuror për vitin 2016 vijon në 200 procedime penale, pa

iu referuar atyre të mbartura nga vitit 2015. Ndërkohë që pjesa i përket dosjeve të mbartura për secilin prokuror ka një ulje të numërit të mbarjtes referuar vitit 2015.

Për vitin 2016 janë përfunduar në gjykim 835 çështje penale dhe 32 çështje që janë ndjekur drejtpërdrejt në gjykatë.

Të ndara sipas prokurorëve, statistikat e çështjeve të gjykuara janë të pasqyruar në tabelën e mëposhteme.

| <i>NR</i>    | <i>Prokurori</i>     | <i>Çështjet në gjykim</i> |
|--------------|----------------------|---------------------------|
| 1.           | <i>F. Cela</i>       | 34                        |
| 2.           | <i>A. Xhaferraj</i>  | 28                        |
| 3.           | <i>A. Ismailukaj</i> | 1                         |
| 4.           | <i>A. Kulici</i>     | 25                        |
| 5.           | <i>A. Pali</i>       | 13                        |
| 6.           | <i>A. Saliu</i>      | 37                        |
| 7.           | <i>A. Zarkaj</i>     | 52                        |
| 8.           | <i>D. Marku</i>      | 123                       |
| 9.           | <i>E. Alvora</i>     | 49                        |
| 10.          | <i>E. Cela</i>       | 50                        |
| 11.          | <i>E. Laze</i>       | 73                        |
| 12.          | <i>E. Mustafaj</i>   | 18                        |
| 13.          | <i>E. Shqarri</i>    | 43                        |
| 14.          | <i>H. Lamaj</i>      | 55                        |
| 15.          | <i>K. Braho</i>      | 2                         |
| 16.          | <i>K. Llaho</i>      | 28                        |
| 17.          | <i>M. Sota</i>       | 32                        |
| 18.          | <i>S. Dautaj</i>     | 19                        |
| 19.          | <i>S. Smaqa</i>      | 74                        |
| 20.          | <i>V. Mata</i>       | 31                        |
| 21.          | <i>Xh. Saliaj</i>    | 48                        |
| <b>TOTAL</b> |                      | <b>835</b>                |

Më i ngarkuar në gjykim ka qënë prokurori Dritan Marku, i cili mbulon seksionin e të miturve në këtë prokurori, ngarkesë që vjen për faktin se procedimet penale në këtë seksion janë me autorë të identifikuar dhe pjesa më e madhe e tyre dërgohen për gjykim. Ngarkesa për prokurorët e tjerë ka qënë më e lartë në krahasim me një vit më parë, diferencat e theksuara i referohen prokurorëve që nuk kanë ushtruar funksionin gjatë gjithë vitit kalendarik.

Krahasuar me vitin 2015 përfaqësimi çështjeve në gjykim ka qënë më i lartë në total, konkretisht në vitin 2016 rezultojnë 835 çështje ndërsa për vitin 2015 rezultojnë 719 çështje. Pra ka një rritje me 119 çështje.

Gjithashtu vlen të përmendet edhe puna e oficerëve të policisë gjyqësore në hetimin dhe përfundimin e procedimeve penale.

Të dhënat për secilin oficer të policisë gjyqësore janë si më poshtë;

| <i>Nr.</i> | <i>Of.Pol. Gjyqësore</i> | <i>Totali i çështjeve</i> | <i>Të përfunduara</i> | <i>Të mbartura</i> |
|------------|--------------------------|---------------------------|-----------------------|--------------------|
| 1          | <i>Granit Çakërrri</i>   | 157                       | 142                   | 15                 |
| 2          | <i>Arben Jorgaqi</i>     | 134                       | 118                   | 16                 |
| 3          | <i>Avni Begaj</i>        | 128                       | 126                   | 2                  |
| 5          | <i>Skërdilajd Qinami</i> | 100                       | 96                    | 4                  |
| 6          | <i>Roland Kamberi</i>    | 149                       | 126                   | 23                 |
| 7          | <i>Mirjan Fani</i>       | 102                       | 61                    | 41                 |
| 8          | <i>Eglantina Nushi</i>   | 22                        | 8                     | 14                 |
| 9          | <i>Arjela Rexhia</i>     | <i>ekzekutimet</i>        |                       |                    |
| 10         | <i>Fatbardh Lala</i>     | 104                       | 88                    | 16                 |

Si edhe shihet nga të dhënat e mësipërme, oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, gjatë vitit 2016 referuar kanë patur një ngarkesë më të paktë pune në krahasim me vitin 2015.

## V. TREGUESIT E NGARKESËS PËR NJËSINË E PËRBASHKËT HETIMORE GJATË VITIT 2016.

Gjatë vitit 2016 në përbërje të Njesisë së Përbashkët Hetimore, kanë punuar katër prokurorë, Drejtuesi i Njesisë, si dhe tre oficerë të policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë, një oficer i policisë gjyqësore i Drejtorisë së Tatimeve. Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2016 në Njësi kanë punuar Drejtuesi i Njesisë Prokurori Klodjan Braho dhe Prokurorët Albert Kulici, Kledjan Llaho, Elion Mustafaj. Në muajin Mars të vitit 2016, Drejtuesi i Njesisë Prokurori Klodjan Braho është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Nga Muaji Mars 2016 është shtuar si pjesë përbërëse e Njesisë edhe Prokurori Arian Xhaferraj. Në muajin Dhjetor 2016, si pjesë e Njesisë së Përbashkët Hetimore është shtuar edhe Prokurori Anton Pali Pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, veprat penale të Njesisë janë hetuar nga oficerët e policisë gjyqësore pranë Sektorit Kundër Krimin Financiar.

Për vitin 2016 nga ana e Njesisë së Përbashkët Hetimore ka pasur një ngarkesë pune të konsiderueshme, si dhe një dinamikë të lartë të veprave penale në hetim dhe në fazën e gjykimit. Për shkakun se në Qarkun Vlorë ka ekzistuar dhe ekziston një problematikë specifike lidhur me njohjen dhe kthimin e pronave, regjistrimin e tyre, ndarjen e tokës bujqësore, problematikë që është e trashëguar nga veprimtaria e intitucioneve të administratës publike në vite, edhe për këtë vit pjesa më e madhe e referimeve penale dhe kallëzimeve

penale lidhen me mosmarrëveshjet e pronësisë, si dhe me veprime apo mosveprime të funksionarëve publike të lidhura me çështjet e pronësisë.

Gjatë vitit 2016 nga NJPH-ja janë trajtuar në total 428 referime penale dhe kallëzime penale, prej të cilave janë rregjistruar 285 procedime penale të reja, si dhe është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 135 referime penale dhe kallëzime penale. Për vitin 2016 numëri i kallëzimeve dhe referimeve penale është ulur në masën 14.4 % krahasuar me vitin 2015, që përkon me 72 kallëzime dhe referime penale më pak, ndërsa numëri i procedimeve penale të reja është ulur në masën 5.3 % krahasuar me vitin 2015, që iu korespondon 16 procedime penale më pak.

Rezulton se gjatë vitit 2016 janë hetuar gjithsej 485 procedime penale duke përfshirë edhe procedimet e mbartura nga viti 2015, janë përfunduar hetimet për 332 procedime penale, 83 janë dërguar për gjykim, është vendosur pushimi për 163 procedime penale, 43 janë pezulluar, ndërsa 43 janë transferuar ose bashkuar. Mbartur për periudhën në vazhdim viti 2017, 153 procedime penale.

Duke iu referuar këtyre të dhënave rezulton se në vitin 2016, janë hetuar 11.5 % më tepër procedime penale se në vitin 2015, që iu korespondon numri prej 56 procedime penale më tepër, janë përfunduar hetimet për 28.9 % më tepër procedime penale krahasuar me vitin 2015, që iu korespondon numri prej 96 procedime penale më tepër, si dhe janë dërguar në gjyq 8.4 % procedime penale më shumë krahasuar me vitin 2015, që iu korespondon numri prej 7 procedime penale më shumë sesa në vitin 2015.

Më konkretisht, po i paraqesim të dhënat për secilin nga Prokurorët në tabelën si më poshte vijon;

Treguesit për vitin 2016 janë si më poshtë;

| Prokurorët  | Totali     | Referime   | Kryesisht | Mosfilluar | Ne vritikim | Mbartur nga viti 2015. | Procedime te reja | Totali i procedime ne hetim | Pushime    | Pezullime | Transferim | Gjykim    | Totali përfunduar hetimet | Mbartur ne hetim per vitin 2017 | Mbartur ne gjykim nga 2015 | Gjithsej ne gjykim | Përfunduar gjykimi gjithsej procedime | Fajesi    | Pafajesie ose pushim | Mbartur ne gjykim per vitin 2017 |
|-------------|------------|------------|-----------|------------|-------------|------------------------|-------------------|-----------------------------|------------|-----------|------------|-----------|---------------------------|---------------------------------|----------------------------|--------------------|---------------------------------------|-----------|----------------------|----------------------------------|
| A.Xh        | 77         | 76         | 1         | 15         | -           | -                      | 62                | 62                          | 12         | 18        | 6          | 14        | 50                        | 12                              | -                          | 14                 | 13                                    | 12        | 1                    | 1                                |
| A.K         | 162        | 157        | 5         | 34         | 2           | 81                     | 45                | 126                         | 55         | 4         | 10         | 24        | 93                        | 33                              | 16                         | 40                 | 22                                    | 18        | 4                    | 18                               |
| K.Li        | 114        | 113        | 1         | 38         | 2           | 69                     | 73                | 142                         | 60         | 8         | 8          | 19        | 95                        | 47                              | 25                         | 44                 | 25                                    | 23        | 2                    | 19                               |
| E.M         | 188        | 183        | 5         | 48         | 4           | 50                     | 86                | 136                         | 35         | 11        | 19         | 24        | 89                        | 47                              | 11                         | 35                 | 16                                    | 15        | 1                    | 19                               |
| A.P         | 19         | 19         | -         | -          | -           | -                      | 19                | 19                          | 1          | 2         | -          | 2         | 5                         | 14                              | -                          | 2                  | -                                     | -         | -                    | 2                                |
| <b>Tot.</b> | <b>560</b> | <b>548</b> | <b>12</b> | <b>135</b> | <b>8</b>    | <b>200</b>             | <b>285</b>        | <b>485</b>                  | <b>163</b> | <b>43</b> | <b>43</b>  | <b>83</b> | <b>332</b>                | <b>153</b>                      | <b>52</b>                  | <b>135</b>         | <b>76</b>                             | <b>68</b> | <b>8</b>             | <b>59</b>                        |



Treguesit për vitin 2015 kanë qënë si më poshtë;

| Mbartur ne gjykim per vitin 2016 | Pafajesie ose pushim | Fajesi     | Pertunduar gjykimi gjithsej procedime | Gjithsej ne gjykim | Mbartur ne gjykim nga 2014 | Mbartur ne hetim per vitin 2016 | Totali pertunduar hetimet | Gjykim     | Transferim | Pezullime | Pushime   | Totali i procedime ne hetim | Procedime te reja | Mbartur nga viti 2014. | Ne vritikim | Mosfilluar | Kryesisht | Referime  | Totali    | Prokuroret |
|----------------------------------|----------------------|------------|---------------------------------------|--------------------|----------------------------|---------------------------------|---------------------------|------------|------------|-----------|-----------|-----------------------------|-------------------|------------------------|-------------|------------|-----------|-----------|-----------|------------|
| K.B                              | 79                   | 67         | 12                                    | 19                 | 1                          | 41                              | 59                        | 100        | 35         | 13        | 5         | 19                          | 72                | 28                     | 18          | 35         | 21        | 17        | 4         | 14         |
| A.K                              | 156                  | 146        | 10                                    | 47                 | -                          | 58                              | 109                       | 167        | 45         | 13        | 12        | 26                          | 96                | 71                     | 10          | 36         | 20        | 16        | 4         | 16         |
| K.LI                             | 127                  | 125        | 2                                     | 44                 | 16                         | 7                               | 67                        | 74         | 5          | 2         | -         | 11                          | 18                | 56                     | 1           | 25         | 4         | 2         | 2         | 21         |
| E.M                              | 70                   | 69         | 1                                     | 7                  | 23                         | 2                               | 40                        | 42         | 1          | -         | 2         | 1                           | 4                 | 38                     | -           | 1          | -         | -         | -         | 1          |
| E.H                              | 68                   | 65         | 3                                     | 42                 | -                          | 20                              | 26                        | 46         | 18         | 9         | -         | 19                          | 46                | -                      | 7           | 8          | 8         | 5         | 3         | -          |
| <b>Tot.</b>                      | <b>500</b>           | <b>472</b> | <b>28</b>                             | <b>159</b>         | <b>40</b>                  | <b>128</b>                      | <b>301</b>                | <b>429</b> | <b>104</b> | <b>37</b> | <b>19</b> | <b>76</b>                   | <b>236</b>        | <b>193</b>             | <b>36</b>   | <b>105</b> | <b>53</b> | <b>40</b> | <b>13</b> | <b>52</b>  |

Treguesit për vitin 2014 kanë qënë si më poshtë;

| Mbartur ne gjykim per vitin 2015 | Pafajesie ose Pushim | Fajesi     | Pertunduar gjykimi gjithsej procedime | Gjithsej ne gjykim | Mbartur ne gjykim nga 2013 | Mbartur ne hetim per vitin 2015 | Totali pertunduar hetimet | Gjykim     | Transferim | Pezullime | Pushime   | Totali procedime ne hetim | Procedime te reja | Mbartur nga viti 2013. | Ne vritikim | Mosfilluar | Kryesisht | Referime  | Totali   | Prokuroret |
|----------------------------------|----------------------|------------|---------------------------------------|--------------------|----------------------------|---------------------------------|---------------------------|------------|------------|-----------|-----------|---------------------------|-------------------|------------------------|-------------|------------|-----------|-----------|----------|------------|
| K.B                              | 97                   | 82         | 15                                    | 28                 | 5                          | 53                              | 64                        | 117        | 41         | 13        | 4         | 27                        | 8                 | 32                     | 14          | 41         | 2         | 19        | 4        | 18         |
| A.K                              | 105                  | 104        | 1                                     | 33                 | 17                         | 17                              | 55                        | 72         | 6          | 1         | 5         | 11                        | 2                 | 49                     | -           | 11         | 2         | 1         | 1        | 9          |
| E.H                              | 156                  | 148        | 8                                     | 73                 | 23                         | 21                              | 60                        | 81         | 24         | 4         | 1         | 12                        | 4                 | 40                     | 3           | 15         | 9         | 7         | 2        | 6          |
| v.o <sup>9</sup>                 | -                    | -          | -                                     | -                  | -                          | 12                              | -                         | 12         | 8          | 2         | -         | 2                         | 1                 | -                      | 13          | 15         | 1         | 11        | -        | 4          |
| <b>Tot.</b>                      | <b>358</b>           | <b>334</b> | <b>24</b>                             | <b>134</b>         | <b>45</b>                  | <b>103</b>                      | <b>17</b>                 | <b>282</b> | <b>79</b>  | <b>20</b> | <b>10</b> | <b>52</b>                 | <b>161</b>        | <b>121</b>             | <b>30</b>   | <b>82</b>  | <b>4</b>  | <b>38</b> | <b>7</b> | <b>37</b>  |

Gjatë vitit 2016 kanë qënë në fazën e gjykimit gjithsej 135 çështje penale. Ka përfunduar gjykimi për 76 çështje penale, 68 prej tyre kanë përfunduar me vendim fajësie, ndërsa për 8 çështje penale është vendosur pafajësi ose pushim i çështjes. Duke iu referuar burimit të njoftimeve të veprave penale të rregjistruara që janë në kompetencë të Njësisë së Përbashkët hetimore, vihet re se gjatë vitit 2016 numri i rasteve të referimeve penale të kryera nga

<sup>9</sup> Ne kete rresht jane shenuar procedime penale qe jane hetuar nga Prokuroret e meparshem te njesise te transferuar, te cilat jane shperndare ne Prokuroret e tjere, qe nuk jane pjese e NJPH-se.

shërbimet e policisë gjyqësore janë në një raport më të vogël sesa numri i kallëzimeve penale të paraqitura nga shtetasit dhe Institucionet.

Për vitin 2016 ka pasur ulje të kallëzimeve penale të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, krahasuar me vitin 2015. Përveç kallëzimeve penale të dërguara drejtëpërdrejt në Prokurori, një pjesë e veprave penale në fushën e tatimeve janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, si rezultat i kontrolleve të përbashkëta të realizuara me organet tatimore. Po kështu, konstatohet ulje e materialeve të referuara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Në vitin 2016 kemi pasur edhe raste të marrjes së informacioneve nga SHISH, ku më pas kemi mbledhur të dhënat e nevojshme në rrugë procedurale dhe kemi filluar hetime proaktive. Megjithëse numëri i rasteve të informacioneve nga SHISH kanë qënë të pakta, vlen për tu theksuar se saktësia e këtyre informacioneve ka qënë e lartë. Për vitin 2016 ka pasur raportime nga DPPP-ja më të ulëta në krahasim me vitin 2015, ndërkohë që është kërkuar nga ana jonë bashkëpunimi i këtij institucioni në të gjitha rastet e hetimit të veprave penale të pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale apo për procedime të tjera penale. Në të gjitha rastet DPPP-ja ka dërguar në mënyrë korrekte informacionet e kërkuara nga ana jonë.

Për vitin 2016, verëhet një ulje e kallëzimeve penale të dërguara nga ana e A.K.K.K.P Tiranë, për shkak se pjesa më e madhe e referimeve nga ana e këtij institucioni është dërguar në vitin 2015. Hetimet lidhur me këto procedime penale, për vetë natyrën dhe problematikën që ato mbartin, kanë një natyrë komplekse si dhe kërkojnë kryerjen e veprimeve të shumta hetimore.

Rastet e procedimeve penale të pushuara që lidhen me referimet e kryera nga ana e A.K.K.K.P Tiranë, kanë qënë për shkakun se vepra penale e falsifikimit të dokumentave ka ndodhur por ndjekja penale është parashkuar për shkak të kalimit të afateve procedurale të parashikuara në nenin 66 të K.Penal. Megjithatë, nga ana jonë janë kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për të provuar faktin penal të falsifikimit të dokumentave dhe në përfundim të hetimeve kemi informuar edhe Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit për rikthimin e pasurive të përfituara padrejtësisht në pronësi të shtetit.

Pavaresisht se disa prej kallëzimeve penale të dërguara nga ana e A.K.K.K.P Tiranë, kanë qënë jo të plota dhe jo në përputhje me kërkesat e nenit 281/4 të K.Pr.Penale, duke mos dërguar bashkëngjitur kallëzimit penal të gjithë dokumentacionin e nevojshëm mbi bazën e të cilit është paraqitur kallëzimi penal. Nga ana jonë në të gjitha rastet është kërkuar me shkresë dërgimi i njesuar me origjinalin i të gjithë dokumentacionit që kishte të bënte me kallëzimet penale përkatëse të referuara nga ana e A.K.K.K.P Tiranë.

Për hetimin e këtyre procedimeve penale, pothuajse në të gjitha rastet, ka qënë e nevojshme kryerja e ekspertimeve dhe ekzaminimeve teknik dhe grafike të dokumentave mbi të cilat bazohen pretendimet e pronësisë, por janë krijuar vonesa në kryerjen e ekspertimeve përkatëse nga Drejtoria e Policisë Shkencore Tiranë.

Problematika tjetër lidhur me hetimin e këtyre kallëzimeve penale qëndron edhe në faktin se shpesh të drejtat e pronësisë së subjekteve të kallëzuara janë konfirmuar edhe me vendime

gjyqësore, të cilat mundën të gjykohen apo rishikohen vetëm nga një Gjykatë më e lartë, si dhe ekziston problematika e parashkrimit të ndjekjes penale pasi veprimet e kundraligjshme janë kryer në një kohë më të hershme se afatet e parashkrimit të ndjekjes penale.

Megjithatë, nga ana jonë në të gjitha rastet është synuar që të verifikohet fakti penal i falsifikimit të dokumentave, pavarësisht nëse ndjekja penale është parashkruar, në mënyrë që të mund të krijohet mundësia procedurale për Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, për të kërkuar në rrugë procedurale civile rikthimin e pasurisë së përfituar padrejtësisht në pronësi të shtetit. Po kështu, për të gjitha rastet janë verifikuar edhe transaksionet e mundshme të kryera lidhur me pronat e përfituara, me qëllim për të verifikuar nëse janë konsumuar elementët e veprës penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, të parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Gjatë vitit 2016 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në kuadër të disa procedimeve penale, është kërkuar sekuestrimi dhe konfiskimi i disa pasurive të paluajtshme dhe konkretisht;

#### V/1. Sekuestrime

- Në kuadër të procedimit penal nr.375, viti 2015, është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*sekuestro preventive*”, për pasurinë me sipërfaqe **6 ha**, e ndodhur në Ksamil, Sarandë.
- Në kuadër të procedimit penal nr.676, viti 2015, është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*sekuestro preventive*”, për pasurinë me sipërfaqe **2 ha**, e ndodhur në Porto Palermo, Himarë.
- Në kuadër të procedimit penal nr.2458, viti 2015, është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*sekuestro preventive*”, për pasurinë me sipërfaqe **87.6 ha**, e ndodhur në fshatin Peshkëpi, Vlorë. Po në kuadër të këtij procedimi penal janë sekuestruar edhe **7.2ha pyll**, e ndodhur në fshatin Peshkëpi, Vlorë.
- Në kuadër të procedimit penal nr.414, viti 2016, është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*sekuestro preventive*”, për pasurinë me sipërfaqe **33 ha**, e ndodhur në Palasë, Vlorë.
- Në kuadër të procedimit penal nr.2321, viti 2014, është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*sekuestro preventive*”, për pasurinë me sipërfaqe **2 ha**, e ndodhur në Porto Palermo, Vlorë.
- Në kuadër të procedimit penal nr.302, viti 2016, është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*sekuestro preventive*”, për pasurinë me sipërfaqe **54 ha**, e ndodhur në Dhermi, Himarë.
- Në kuadër të procedimit penal nr.266, viti 2016, është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*sekuestro preventive*”, për pasurinë me sipërfaqe **220 ha**, e ndodhur në Karaburun, Vlorë.
- Në kuadër të procedimit penal nr.266, viti 2016, është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*sekuestro preventive*”, për pasurinë me sipërfaqe **89 ha**, e ndodhur në Zvernec, Vlorë.

- Në kuadër të procedimit penal nr.366, viti 2015, është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*sequestro preventive*”, për pasurinë me sipërfaqe **49.7 ha**, e ndodhur ne Ksamil, Sarande.
- Në kuadër të procedimit penal nr.389, viti 2015, është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*sequestro preventive*”, për pasurinë me sipërfaqe **270m2** si dhe **hotel 5-kate**, ndodhur ne Dhermi, Himare.

Si konkluzion, rezulton se per vitin 2016, eshte vendosur sekuestro preventive me vendim Gjykate, per nje sipërfaqe totale prej **543.3 ha**, e llojit toke truall, kullote, bujqesore dhe pyll. Gjithashtu eshte vendosur sekuestro preventive per nje sipërfaqe trualli prej **270m2** si dhe nje godine sherbimi hotel, prej **5-kate**. Pra vihet re rritja ne menyre te konsiderueshme, e sekuestrimeve te pasurive qe jane produkt i veprave penale te parashikuar nga neni 186 dhe 248 i Kodit Penal.

Vlen per tu theksuar se numri me i madh i çeshtjeve per te cilat eshte vendosur masa e sekuestros preventive, jane derguar per gjykim dhe pritet konfiskimi i tyre me vendim gjyqesor.

#### V/2. Konfiskimet

- Në kuadër të procedimit penal nr.1204/2015 është vendosur konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit të pasurise se paluajtshme me sipërfaqe prej 8.5ha, e ndodhur ne Palase, Vlore.
- Në kuadër të procedimit penal nr.2457/2015 është vendosur konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit të pasurise se paluajtshme me sipërfaqe prej 40 ha, e ndodhur ne fshatin Tragjas, Vlore.
- Shumat monetare 20.000 (njetete mije euro) dhe 100.000 (njqind) mije euro, ne kuader te procedimit penal nr.2224/2015, regjistruar per vepren penale te parashikuar nga neni 245/1 te Kodit Penal.
- Siperfaqe prej 85.000m2 kullote, e ndodhur ne vendin e quajtur “Mursia”, fshati Palasë, Himare, e cila eshte kthyer me vendimin me nr.415 date 03.12.2008 te ish-Z.R.K.K.P Vlore.

Lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 259 i K.Penal është për tu përmëndur se referimet penale lidhur me këto vepra penale kanë qënë të pakta nga ana e sherbimeve te policise gjyqesore dhe me një nivel të ulët të dhënash. Nga ana jonë në të gjitha rastet këto referime penale janë rregjistruar si procedime penale, si dhe janë autorizuar përgjime në vënde publike dhe private, duke u hetuar rastet e paraqitura me hetime proaktive.

Gjatë vitit 2016 janë dërguar për gjykim persona që kanë ushtruar funksionet publike më të larta në Institucionet vendore të Qarkut Vlorë. Konkretisht, janë dërguar për gjykim çështje penale më të pandehur të zgjedhur vendorë të Bashkisë Vlorë, ish-Kryetari i Bashkise Vlore, ish-Regjistruesi i ZVRPP Vlore, ish-Drejtuues te INUV Bashkia Vlore, specialiste te institucioneve te ndryshem prane ZVRPP, IMT Bashkia Vlore, etj.Keto raste ndodhen ne proces gjykimi prane Gjykares se Rrethit Gjyqesor Vlore.

Përvec sa përmëndëm më sipër, lidhur me numrin më të vogël të referimeve penale në raport me kallëzimet penale të Institucioneve të tjera apo të paraqitura nga shtetasit, konstatohet që pothuajse në të gjitha rastet edhe këto referimeve penale të dërguara, janë të lidhura me kallëzime penale të shtetasve të cilët paraqesin kallëzim penal jo drejtëpërdrejtë në Prokurori, por e paraqesin kallëzim penal pranë shërbimeve të policisë gjyqësore, të cilat përcillen më pas në formën e referimeve penale. Në raste përjashtimore janë kryer referime penale për rrethana dhe fakte për të cilat policia gjyqësore ka marrë dijeni me iniciativën e saj.

Gjithashtu, është edhe për tu përmëndur fakti se gjatë vitit 2016 nuk ka pasur asnjë hetim proaktiv të filluar nga policia gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Tiranë, ndaj ndonjë funksionari publik në institucionet vendore të Qarkut Vlorë.

Është e nevojshme që shërbimet e policisë gjyqësore të kenë një rol më aktiv në drejtim të mbledhjes dhe përpunimit të informacionit me iniciativën e tyre për vepra penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, si dhe në drejtim të mbledhjes së të dhënave të nevojshme me qëllim fillimin e hetimeve proaktive dhe realizimin e tyre në mënyrë sa më të suksesshme.

## **VI. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME JASHTË GJATË VITIT 2016.**

Gjatë vitit 2016, rezulton se ka patur një ngarkesë të konsiderueshme pune edhe në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja dhe konkretisht gjatë këtij viti i janë dërguar autoriteteve gjyqësore kompetente 27 kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale, ndërkohë që janë dërguar prej autoritetet gjyqësore të huaja në drejtim të Prokurorisë Vlorë 23 kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale. Po kështu, rezulton se për këtë vit janë kërkuar 5 njohje vendimi penal të huaj dhe janë ekzekutuar 4 procedura për arrestime të përkohshme me qëllim ekstradimi, për të cilat në të gjitha rastet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka miratuar ekstradimin. Në një rast, rezulton që të jetë kërkuar ekstradimi i një shtetasi turk me banim në qytetin e Vlorës, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave” ku më pas është tërhequr kërkesa nga shteti kërkues.

Përsa i përket shpalljes në kërkim ndërkombëtar rezulton se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, janë bërë 16 urdhëra për shpallje në kërkim ndërkombëtar dhe janë bërë 4 urdhëra për heqje nga kërkimi ndërkombëtar.

Konstatohet një korrektësi maksimale në raport me autoritetet gjyqësore të huaja në përmbushjen e detyrimeve ligjore, në një kohë kur pritet që edhe autoritet e huaja gjyqësore të na përgjigjen me të njëjtën shkallë korrektësie.

## VII. EKZEKUTIMET E VENDIMEVE PENALE GJATË VITIT 2016.

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për ekzekutimin e vendimeve penale gjatë vitit 2016 ka funksionuar seksioni përkatës , me prokuror të këtij seksioni Skënder Dautaj, dhe o.p.gj. Arjela Rexha. Për shkak të ngarkesës së punës, prokurori S.Dautaj njëkohësisht ka qenë edhe prokuror i Seksionit të të Miturve pranë kësaj prokurorie.

Gjatë vitit 2016 rezulton se janë nxjerrë në total 1412 urdhëra ekzekutimi, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë. Nga këto urdhëra rezulton se 304 prej tyre janë nxjerrë për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës për dënimet me burgim , përfshirë këtu edhe dënimet në mungesë. Numëri i urdhërave të ekzekutimit për dënimet me gjobë është 166 urdhëra dhe rezulton se nga ky seksion janë nxjerrë urdhëra për shërbimin e provës në total 355 . referuar kësaj të fundit, konstatohet nga statistika se 28 urdhëra ekzekutimi janë nxjerrë në ekzekutim të vendimeve të gjykatës për punë në interes publik dhe 327 urdhëra për nenin 59 të Kodit Penal.

Vlen të theksohet se një pjesë e urdhërave të ekzekutimit, në total në numër 382, janë nxjerrë në kuadër të ligjit “Për amnistinë” nr.154/2015 dhe 203 urdhëra ekzekutimi përfshijnë pjesën më gjobë etj.

Në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale problematika kryesore është e lidhur me adresat e të dënuarve. Vështirësi ka patur gjatë fazës së ekzekutimit ndjekja e përmbushjes së dënimit alternativ që kanë të bëjnë me shkollimin, punësimin, moslargimin nga vendi i banimit, mospërdorimin e pijes alkolike apo lendëve narkotike, mosshoqërimi me persona të dënuar etj. Ndjekja e kësaj faze ekzekutimi kërkon një bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë të punës midis Shërbimit të Provës, Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë.

## VIII. ADMINISTRIMI I PROKURORISË PËR VITIN 2016

### VIII/1. Marrëdhëniet me zyrën e financës.

Aktiviteti i zyrës së financës është i lidhur drejtpërdrejt me mbarëvajtjen e punës së prokurorisë dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore gjatë një procedimi të rregullt penal. Zyra e financës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë , për vitin 2016 ka shlyer detyrimet për ekspertë, avokatë, përkthyes në shumën 4.513.563 lekë ( ku përfshihen edhe shpërqërbimet për ekspertimet mjekoligjore 2002-2004). Për vitin 2017, mbartet një detyrim financiar në lidhje me pagesat e ekspertëve, avokatëve dhe përkthyesve në vlerën 739.500 lekë.

### VIII/2. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.

Gjatë vitit 2016 është synuar rritja e bashkëpunimit sidomos me strukturat e policisë së shtetit, si një nga bashkëpunuesit kryesor për përmirësimin e punës dhe arritjen e suksesit në hetimin e çështjeve penale si dhe evidentimin e situatave problematike. Ky bashkëpunim

ndërsituacional ka qënë produktiv dhe mbështetës për kërkesat e policisë por edhe për delegimet e veprimeve hetimore dhe kryerja e detyrave nga ana e tyre. Ka qënë një bashkëpunim i fokusuar jo vetëm në nivel drejtimi por një bashkëpunim edhe në nivelin bazë. Ka pasur komunikim të vazhdueshëm përsa i përket ngjarjeve të rënda dhe me ndikim në opinion publik sikurse dhe nga ana e prokurorisë në çdo rast nuk ka munguar prezenca e prokurorit në vendngjarje. Synohet në këtë drejtim rritja e bashkëpunimit, përmirësimi i punës së oficerëve të policisë gjyqësore, rritja e komunikimit mes tyre dhe prokurorit në kryerjen e detyrave të përcaktuara në urdhërin e delegimit apo për kryerje veprimesh hetimore, moszvarritja e pajustificuar e hetimit me qëllim ritjen e cilësisë së hetimit për të qënë më të suksesshëm në parandalimin dhe goditjen, sidomos të veprave penale më të përhapura në këtë rreth.

Ka vjuar gjithashtu një bashkëpunim pozitiv dhe për tu përgëzuar me organet e pushtetit vendor dhe institucionet e tjera lokale, bashkëpunim ky i fokusuar kryesisht në marrjen e informacionit të kërkuar në interes të hetimit, në një kohë sa më të shpejtë.

Bashkëpunim specifik dhe me rëndësi të veçantë është ai që i përket institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, konkretisht me IEVP Vlorë dhe Shërbimin e Provës , ku në rastin e këtij të fundit ka vend për përmirësim.

Referuar të dhënave statistikore, padiskutim që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka qënë mbështetës pozitiv në punën dhe qëndrimet e organit të akuzës. Ky bashkëpunim konstatohet si në qëndrimet për masat e dënimit ashtu edhe në përkrahjen ligjore, proceduriale për pjesën e hetimit me metoda speciale (përgjimet). Ajo që mbetet të rishikohet në këtë bashkëpunim janë kryesisht qëndrimet e ndryshme të mbajtura për një kategori të caktuar veprash penale apo masash sigurimi.

Në vijim të këtij bashkëpunimi , ka qënë mjaft produktiv , i shpejtë dhe korrekt komunikimi zyrtar në lidhje me shkresat, kthimet e përgjigjeve, vënia në dispozicion e dokumentacionit të kërkuar. Në këtë drejtim nga ana e administratës së Gjykatës Vlorë, ka pasur një bashkëpunim maksimal , profesional, duke mbështetur organin e akuzës dhe punën e tij.

Me Prokurorinë e Apelit Vlorë vazhdojnë të ruhen marrëdhënie të mira shoqërore dhe institucionale. Kjo prokurori na ka mbështetur në të gjitha kërkesat tona të ligjshme dhe ka orientuar qëndrimin tonë për çështje konkrete.

Një bashkëpunim i vecantë dhe produktiv ka qënë për vitin 2016, bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme, në krijimin dhe vënien në dispozicion të ekspertëve të pavaruar në fusha të caktuara , i cili ka dhënë zgjidhje problemeve me ekspertët dhe shpejtësinë e hetimit.

### **VIII/3. Etika**

Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve, synojnë të krijojnë, ruajnë dhe forcojnë rregullat e sjelljes, si dhe të rrisin efikasitetin e të gjithë prokurorëve në ushtrimin e funksioneve Kushtetuese dhe ligjore, për llogari të shoqërisë, në interes të publikut dhe në emër të shtetit, si pjesë e sistemit të drejtësisë penale dhe shtetit të së drejtës. Rregullat përkrahin zbatimin e

standardeve të larta të sjelljes profesionale të prokurorëve të gjithë niveleve, në përshtatje me sjelljen e duhur në zyrë, në gjykatë dhe jashtë zyrës së tyre, si edhe për forcimin e dinjitetit, pavarësisë dhe integritetit profesional e personal të tyre. Ato shërbejnë si udhëzues për të gjithë prokurorët dhe kandidatët për prokuror në vend, për të rritur ndërgjegjësimin, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në ushtrimin e funksioneve të tyre, si edhe plotësojnë kuadrin e akteve normative të nxjerra për prokurorët, me synim rritjen e transparencës dhe besimit të publikut ndaj prokurorëve.

Në drejtim të respektimit të etikës është treguar kujdes maksimal nga ana e prokurorëve të këtij institucioni, duke treguar sjelljen profesionale, korrekte me të gjitha subjektet e procedimit penal e më tej.

Është respektuar kodi etik si dhe çdo detyrë është ushtruar në përputhje me aktet dhe ligjet në fuqi.

## **IX. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Vlorë, duke pasur në vëmendje të saj analizën vjetore, arritjet dhe nevojën për përmirësim, shtrirjen dhe përhapjen e kriminalitetit, grupveprat penale më shqetësuese aktualisht ka përcaktuar prioritetet për vitin në vazhdim :

- Rritja e efektivitetit të ndjekjes penale ndaj veprave penale me tendencë në rritje të kriminalitetit,veçanërisht e veprave penale në fushën e narkotikëve.
- Konsolidimin e luftës kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit në vijom të punës së kryer nga njësia e përbashkët hetimore (seksioni i krimit ekonomik dhe korrupsionit.
- Bashkëpunimi më i lartë me strukturat e policisë për krimet e rënda si dhe kontrollet e veprimtarisë së policisë gjyqësore.
- Vëmendje e veçantë ndaj grupeve vulnerabël. Prokuroria do të vazhdojë të ndjekë një politikë penale të përshtatshme ndaj të miturve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara që procedohen penalisht, apo edhe ndaj personave që akuzohen për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si në caktimin e masave të sigurimit ashtu edhe në aplikimin e dënimeve alternative
- Forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me të gjitha institucionet që kanë shërbime të policisë gjyqësore dhe koordinimi me institucione të tjera ligjzbatuese si domosdoshmëri në punën e organit të prokurorisë;
- Forcimin e bashkëpunimit bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar dhe bashkëpunimit me agjensitë e huaja të zbatimit të ligjit;
- Përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore për përmirësimin e kushteve dhe ambjenteve të punës për prokurorët mbetet një objektivi i rëndësishëm edhe për vitin 2016;



Në vazhdim të punës tonë dhe arritjeve Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë synon të përmirësojë në vijim hetimin e ndjekjes penale, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, respektimin e kushtetutës dhe ligjeve në fuqi duke i treguar profesionalizëm dhe sjellje etike.

*Bashkëlidhur treguesit statistikorë 2 vjeçar të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal.*

**Duke ju falënderuar për vëmendjen!**

**DREJTUESI PROKURORISË**

**Ramadan TROCI**

Treguesit statistikore 2 vjeçar të veprave penale sipas strukturës së kodit penal (pika 2, shkronja b) dhe pika III e aneksit të udhëzimit nr.330, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Pergjithshëm)

| KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE                          | 2015            |                      |                   |                      |                 | 2016            |                      |                                 |                      |                 |
|---|-----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|-----------------|----------------------|---------------------------------|----------------------|-----------------|
|   | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. <sup>10</sup> | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 76 Vrasja <sup>11</sup>                          |                 |                      |                   | 1                    | 1               | 5               | 2                    | 4                               | 4                    |                 |
| Neni 77 Vrasja për një krim tjetër                    |                 |                      |                   |                      |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 78 Vrasja me paramendim                          | 6               | 1                    | 1                 | 1                    | 4               | 4               | 2                    | 5                               | 4                    | 1               |
| Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje                       |                 |                      |                   |                      |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese                  |                 |                      |                   |                      |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë              |                 |                      |                   |                      |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit  | 1               |                      |                   |                      |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare |                 |                      |                   |                      |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 80   | 1               | 1                    |                   | 2                    |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 81 Vrasja e foshnjës                             |                 |                      |                   |                      |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 82 Vrasja në tronditje psikike                   |                 |                      |                   |                      |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme               |                 |                      |                   |                      |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje           |                 |                      |                   |                      |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje                       |                 |                      |                   |                      |                 |                 |                      |                                 |                      |                 |
| Neni 84 Kanosja                                       | 28              | 13                   | 8                 | 13                   | 7               | 40              | 16                   | 17                              | 18                   | 4               |
| <b>Totali</b>   | <b>36</b>       | <b>15</b>            | <b>9</b>          | <b>17</b>            | <b>12</b>       | <b>49</b>       | <b>20</b>            | <b>26</b>                       | <b>26</b>            | <b>5</b>        |

<sup>10</sup> Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.

<sup>11</sup> Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë (10 procedime regjistruar dhe 12 pandehur + persona nën hetim regjistruar).

| KRIME KUNDËR JETËS<br>SHKAKTUAR ME<br>PAKUJDESI | 2015                  |                               |                        |                              |                       | 2016                  |                               |                         |                               |                       |
|---|-----------------------|-------------------------------|------------------------|------------------------------|-----------------------|-----------------------|-------------------------------|-------------------------|-------------------------------|-----------------------|
|   | Nr.<br>Procd.<br>Regj | Nr.<br>procd<br>per<br>gjykim | Nr. i<br>pand.<br>Regj | Nr.<br>Pand<br>per<br>gjykim | Nr.<br>Pand<br>denuar | Nr.<br>Procd.<br>Regj | Nr.<br>procd<br>per<br>gjykim | Nr. i<br>pand.<br>Regj. | Nr.<br>Pand.<br>Per<br>gjykim | Nr.<br>Pand<br>denuar |
| Neni 85 Vrasja nga pakujdesia                   | 2                     |                               |                        |                              |                       | 2                     | 1                             | 2                       | 1                             |                       |
| <b>Totali</b>                                   | <b>2</b>              |                               |                        |                              |                       | <b>2</b>              | <b>1</b>                      | <b>2</b>                | <b>1</b>                      |                       |

| VEPRA PENALE KUNDËR<br>SHËNDETIT TË KRYERA<br>NGA PAKUJDESIA | 2015                  |                               |                         |                               |                       | 2016                 |                               |                        |                              |                       |
|--|-----------------------|-------------------------------|-------------------------|-------------------------------|-----------------------|----------------------|-------------------------------|------------------------|------------------------------|-----------------------|
|  | Nr.<br>Procd.<br>Regj | Nr.<br>procd<br>per<br>gjykim | Nr. i<br>pand.<br>Regj. | Nr.<br>Pand.<br>Per<br>gjykim | Nr.<br>Pand<br>denuar | Nr.<br>Procd<br>Regj | Nr.<br>procd<br>per<br>gjykim | Nr. i<br>pand.<br>Regj | Nr.<br>Pand<br>per<br>gjykim | Nr.<br>Pand<br>denuar |
| Neni 91 Plagosje e rëndë nga pakujdesia                      |                       |                               |                         |                               |                       | 1                    |                               |                        |                              |                       |
| Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia                      |                       |                               |                         |                               |                       |                      |                               |                        |                              |                       |
| <b>Totali</b>  |                       |                               |                         |                               |                       | <b>1</b>             |                               |                        |                              |                       |

| VEPRA PENALE QË<br>RREZIKOJNË JETËN DHE<br>SHËNDETIN NGA<br>NDËRPRERJA E<br>SHTATZANISË OSE NGA<br>MOSDHËNIA E NDIHMËS | 2015                  |                               |                         |                               |                       | 2016                  |                               |                         |                               |                       |
|--|-----------------------|-------------------------------|-------------------------|-------------------------------|-----------------------|-----------------------|-------------------------------|-------------------------|-------------------------------|-----------------------|
|  | Nr.<br>Procd.<br>Regj | Nr.<br>procd<br>per<br>gjykim | Nr. i<br>pand.<br>Regj. | Nr.<br>Pand.<br>Per<br>gjykim | Nr.<br>Pand<br>denuar | Nr.<br>Procd.<br>Regj | Nr.<br>procd<br>per<br>gjykim | Nr. i<br>pand.<br>Regj. | Nr.<br>Pand.<br>Per<br>gjykim | Nr.<br>Pand<br>denuar |
| Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas  |                       |                               |                         |                               |                       |                       |                               |                         |                               |                       |
| Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautoriz.  |                       |                               |                         |                               |                       |                       |                               |                         |                               |                       |
| Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë   |                       |                               |                         |                               |                       |                       |                               |                         |                               |                       |
| Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm   | 2                     |                               |                         |                               |                       | 1                     | 2                             | 4                       | 4                             |                       |
| Neni 97 Mosdhënia ndihmë   |                       |                               |                         |                               |                       |                       |                               |                         |                               |                       |
| Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes  |                       |                               |                         |                               |                       |                       |                               |                         |                               |                       |
| Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes  |                       |                               |                         |                               |                       | 3                     |                               |                         |                               |                       |
| <b>Totali</b>  | <b>2</b>              |                               |                         |                               |                       | <b>4</b>              | <b>2</b>                      | <b>4</b>                | <b>4</b>                      |                       |

| KRIME SEKSUALE  | 2015            |                      |                   |                      |                 | 2016           |                      |                  |                     |                 |
|---|-----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
|   | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Procd Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur                                       |                 |                      |                   |                      |                 | 1              |                      |                  |                     | 1               |
| Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç      | 1               | 1                    | 1                 | 1                    |                 | 2              |                      | 2                |                     |                 |
| Neni 102 M. Seksuale me dhunë me të rritura                                     | 2               |                      | 1                 |                      |                 |                |                      |                  |                     |                 |
| Neni 102/a M. Homoseksuale me dhunë me të rritur                                |                 |                      |                   |                      |                 |                |                      |                  |                     |                 |
| Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur             | 3               | 1                    | 1                 | 1                    |                 |                |                      |                  |                     |                 |
| Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksualeme kërkënim me përdorimin e armës |                 |                      |                   |                      |                 |                |                      |                  |                     |                 |
| Neni 105 M. Sek/ homoseksuale duke shpërdoruar detyrën                          |                 |                      |                   |                      |                 |                |                      |                  |                     |                 |
| Neni 106 M. Sek/ homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari             | 1               | 1                    | 1                 | 1                    |                 | 2              |                      |                  |                     |                 |
| Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike                                  |                 |                      |                   |                      |                 |                |                      |                  |                     |                 |
| Neni 108 Vepra të turpshme  | 5               | 3                    | 3                 | 3                    | 1               | 3              | 2                    | 2                | 2                   | 3               |
| <b>Totali</b>   | <b>12</b>       | <b>6</b>             | <b>7</b>          | <b>6</b>             | <b>1</b>        | <b>8</b>       | <b>2</b>             | <b>4</b>         | <b>2</b>            | <b>4</b>        |

| VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT                                     | 2015            |                      |                   |                      |                 | 2016           |                      |                  |                     |                 |
|--|-----------------|----------------------|-------------------|----------------------|-----------------|----------------|----------------------|------------------|---------------------|-----------------|
|  | Nr. Procd. Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pand denuar | Nr. Procd Regj | Nr. procd per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pand denuar |
| Neni 109 Rrembimi ose mbajtja peng e personit                              | 2               |                      |                   |                      |                 | 4              | 1                    | 2                | 1                   |                 |
| Neni 109/a Rrembimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuese     |                 |                      |                   |                      |                 |                |                      |                  |                     |                 |
| Neni 109/b Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurise | 2               |                      | 3                 |                      |                 |                |                      |                  |                     |                 |
| Neni 109/c Zhdukja me forcë  |                 |                      |                   |                      |                 |                |                      |                  |                     |                 |
| Neni 110 Heqja e paligjshme e lirise                                       | 6               | 3                    | 4                 | 4                    |                 | 1              | 1                    | 1                | 1                   | 1               |
| Neni 111 Rrembimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera                 |                 |                      |                   |                      |                 |                |                      |                  |                     |                 |
| Neni 112 Dhunimi i baneses   | 2               |                      |                   |                      |                 |                |                      |                  |                     |                 |
| <b>Totali</b>  | <b>12</b>       | <b>3</b>             | <b>7</b>          | <b>4</b>             |                 | <b>5</b>       | <b>2</b>             | <b>3</b>         | <b>2</b>            | <b>1</b>        |

| VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT                    | 2015             |                       |                   |                      |                | 2016             |                       |                  |                     |                |
|---|------------------|-----------------------|-------------------|----------------------|----------------|------------------|-----------------------|------------------|---------------------|----------------|
|   | Nr. Proce d Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj. | Nr. Pand. Per gjykim | Nr. Pandenu ar | Nr. Proce d Regj | Nr. proced per gjykim | Nr. i pand. Regj | Nr. Pand per gjykim | Nr. Pandenu ar |
| Neni 113 Prostitucioni  |                  |                       |                   |                      |                |                  |                       |                  |                     |                |
| Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit                         | 5                | 4                     | 1                 | 4                    |                | 7                | 3                     | 12               | 10                  | 3              |
| Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion                  |                  |                       |                   |                      |                |                  |                       |                  |                     |                |
| Neni 117 Pornografia  |                  |                       |                   |                      |                |                  |                       |                  |                     |                |
| Neni 118 Dhunimi i varreve                                    | 2                |                       |                   |                      |                |                  |                       |                  |                     |                |
| Neni 119 Fyerja   |                  |                       |                   |                      |                |                  |                       |                  |                     |                |
| Neni 120 Shpifja  | 1                |                       |                   |                      |                |                  |                       |                  |                     |                |
| Neni 121 Ndërhyrje të padrejta në jetën private               | 1                |                       |                   |                      |                |                  |                       |                  |                     |                |
| Neni 121/a Përndjekja   | 5                | 2                     | 2                 | 2                    |                | 7                | 2                     | 2                | 2                   | 2              |
| Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake                         |                  |                       |                   |                      |                |                  |                       |                  |                     |                |
| Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës |                  |                       |                   |                      |                |                  |                       |                  |                     |                |
| <b>Totali</b>   | <b>14</b>        | <b>6</b>              | <b>3</b>          | <b>6</b>             |                | <b>14</b>        | <b>5</b>              | <b>14</b>        | <b>12</b>           | <b>5</b>       |

| VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES                              | 2015             |                       |                   |                      |                | 2016             |                       |                  |                     |                |
